



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji | shkurt 2010

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

UBT ME OBJEKT TË RI UNIVERSITAR

Në UBT u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Akademik të UBT-së...[FQ3](#)

STUDIMET BACHELOR NË UBT, MASTER NË POLITECNICO DI MILANO

"Qëllimi im kryesor do të jetë, që gjithë eksperiencën e fituar...[FQ9](#)

QENDRA GJENETIKE E KOSOVËS

Qendra Gjenetike e Kosovës për mbarsim artificial të Gjedheve është një projekt që ...[FQ10-11](#)

PËRPARËSITË E SHKOLLIMIT TË LARTË PRIVAT

Shkollimi është liri dhe e drejtë e popujve të botës. Në vendet demokratike kjo e drejtë...[FQ14](#)

MËSIMDHËNËSI I PËRKRYER

Marrëdhënie të mira me nxënësët, respektimi i tyre, aftësi për të organizuar dhe menaxhuar klasën si dhe përgatitje korrekte...[FQ16](#)

ARKITEKTURA ËSHTË MË SHUMË SE NJË DIZAJN I ZBUKURUAR

"Arkitektura në Kosovë duhet ta zhvillojë identitetin...[FQ18](#)

UBT EDHE ME EKIP BASKETBOLLI

Ekipi i basketbollit UBT u formua në fund të vitit 2009. Trajneri është Shkumbin Shahini...[FQ31](#)

UBT NXJERR EKSPERTË TË MEKATRONIKËS

Mekatronika filloi që të zbatohet qysh në shekullin e kaluar në vendet më të...[FQ6](#)

UBT ËSHTË NDRYSHE

Është ndryshe të ligjëroni në UBT, në krahasim me universitetin tim amë apo në shkolla të tjera në Bashkimin Europian sepse këtu...[FQ8](#)

Jeni shembull

Do të doja që të gjithë studentët e mi në Austri, të ishin aq të motivuar sikurse studentët në UBT. Universiteti për Biznes dhe Teknologji është definitivisht shumë i orientuar në të ardhmen, duke iu përshtatur me përsosmëri kërkesave të një ekonomie dhe shoqërie që po rritet shpejt. Prof. Werner Retschitzegger, flet për UBT News.[FQ4-5](#)



Editorial

UBT – sinonim i cilësisë dhe i suksesit

**EDMOND HAJRIZI**
President i UBT-së**BOLOGNA**

Më 11 mars 2010 në Universitetin e Vjenës do të prezantohet gjendja aktuale dhe trendet e zhvillimit të procesit të Bolognës. Curricula, Diploma, ECTS, mobiliteti, bashkëpunimi ndërkombëtar, diploma të dyfishta, siguri i cilësisë, inovacionet, transferi i teknologjisë, stafi akademik, hulumtimi shkencor, lidhja me ekonominë, projekte të përbashkëta publike dhe private, përfaqësim në gara të konkurrueshmërisë, punësimi, alumni, etj. Të gjitha tashmë janë të njohura për studentët e UBT-së.

AKREDITIMI

UBT ka hyrë në procesin e akreditimit për vitin e ri akademik 2010/2011. Procesi i vetëvlerësimit ka përfunduar me sukses të plotë. Tani jemi duke pritur vlerësimin e jashtëm. Në vitin e ardhshëm akademik ne mendojmë të hapim edhe drejtime të reja të studimeve, për të plotësuar spektrin e fushave akademike universitare. Në ndërkohë, kemi përfunduar me sukses auditimin e jashtëm për sigurimin e cilësisë në UBT konform ISO 9001. Edhe ky auditim tregon se UBT është një hap më përpara se Universitetet e tjera. Jo vetëm se UBT është universiteti i vetëm që posedon një

certifikim të tillë, por edhe për faktin e krijimit të një sistemi universitar shumë dinamik dhe inovativ. Vitin e fundit ekspertët e jashtëm ishin shumë të fascinuar me cilësinë e studentëve tanë. Pse të mos jetë edhe në këtë vit ashtu ose edhe më mirë ... ne jemi "Top Students" apo jo.

HULUMTIMI DHE STUDENTËT

Ky vit akademik do të jetë një vit edhe më intensiv për sa i përket fushës së hulumtimeve në UBT. Më e veçanta e saj do të jetë involvimi edhe më i shtuar i studentëve në hulumtim. Më konkretisht, studentët e UBT-së jo vetëm që studiojnë, por ata janë të angazhuar edhe në gjenerimin e dijeve dhe teknologjive të reja, se bashku me stafin akademik, që janë të nevojshme për zhvillimin e shoqërisë.

Studentet e IT-së po marrin pjesë në përgatitjet për Kampionatin e ri Evropian të Robotikës.

Studentet e Biznesit po zhvillojnë Biznes-planet e tyre për paraqitjen e ideve të tyre te reja.

Studentet e Arkitekturës po presin kolegët e tyre nga Kalifornia e Shteteve të Bashkuara për të organizuar një work-shop të përbashkët. Studentët e Drejtësisë, Shkencave

Politike dhe Diplomacisë po i përgatisin punimet e tyre hulumtuese për përfundimin e studimeve. Prej tani UBT-së do t'i shtohet edhe Instituti për Studime Ekonomike.

PRAKTIKA DHE PUNËSIMI

UBT ka përgatitur një projekt të ri në këtë semestër për studentët e vet. Ekspertë të psikologjisë dhe ekspertë ndërkombëtarë janë ftuar të marrin pjesë në përgatitjen e studentëve për tregun e punës, praktikës dhe punësimin në UBT. Për këtë edhe bashkëpunimi me bizneset dhe institucionet e Kosovës është duke u rritur dita-ditës. Dëshirojmë që statistikisht tona (100% punësim për të diplomuarit tanë) t'i ruajmë, sepse ekziston një kërkesë e vazhdueshme për individë që kanë përfunduar një edukim cilësor.

KAMPUSI I UBT-SË

Studentët e UBT (ata të drejtimit të arkitekturës) së bashku me profesorët e tyre po përgatisin projektin e kampusit të ardhshëm universitar të UBT-së. A nuk është kjo një ëndërr që po bëhet realitet?

Edhe UBT News tani më është realitet. Edhe diseni po më pëlqen... URIME dhe SUKSESE!

— I M P R E S U M —

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së.
KRYEREDAKTORE: Naile Demiri
REDAKTOR PERGJEGJES DHE REALIZIMI TEKNIK: Herolind Beqaj.
ADRESA: www.ubt-uni.net



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

Viti akademik 2010/2011

UBT me objekt të ri universitar

“Kemi zyrtarizuar marrëveshjen me Kuvendin Komunal të Lipjanit për ndarjen e truallit për ndërtimin e kampusit të ri universitar të Universitetit për Biznes dhe Teknologji, në hapësirën në afërsi të QMI-së. Tash jemi duke punuar në planin arkitektonik dhe deri në fund të shkurtit ose në fillim të marsit do të nis ndërtimi i kampusit. Viti i ri akademik 2010/2011 do të fillojë në kampusin e ri”, - tha presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi në mbledhjen e Këshilli Akademik të këtij universiteti.



Në UBT u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit Akademik. Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi, anëtarët e Këshillit Akademik si dhe profesorët, analizuan dhe shqyrtuan disa çështje më rëndësi për punën dhe zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit. Ajo që u theksua si shumë e rëndësishme ishte çështja e aplikimit dhe akreditimit të programeve të reja në Agjencionin e Akreditimit. “Kemi të elaboruar mirë programet. Ndërtimtaria me infra-strukturë, si në studime themelore ashtu edhe master. Kam bërë analiza në më shumë se 15 universitete të rajonit dhe kemi krijuar një program shumë të mirë me standarde shumë

të larta”, tha prof. Fetah Jagxhiu. “Është domosdoshmëri e kohës që edhe në Kosovë të ketë studime evropiane dhe marrëdhënie ndërkombëtare, ndaj ne duhet të kemi një program të tillë, sepse universitetet vendas nuk e zhvillojnë ketë kurs. Pasi që e kanë të gjitha shtetet e Evropës këtë program, pse mos të ketë edhe në Kosovë. Ketë studim UBT mund ta zhvillojë baras me shtetet e Evropës siç është duke i zhvilluar programet që janë në proces”, - tha prof. Emrush Ujkani. “Ditë më parë kemi zyrtarizuar marrëveshjen me Kuvendin komunal të Lipjanit për ndarjen e truallit për ndërtimin e

kampusit të ri universitar të UBT-së, në hapësirën në afërsi të QMI-së. Tash jemi duke punuar në planin arkitektonik dhe deri në fund të muajit shkurt ose në fillim të muajit mars do të nis ndërtimi i kampusit. Viti i ri akademik 2010/2011 do të fillojë në kampusin e ri”, tha presidenti i UBT-së, Edmond Hajrizi, duke shtuar së projekti në fjalë është projektuar nga stafi akademik ndërkombëtar e vendor dhe studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT.

BASHKËPUNIMET NDËRSHQIPTARE DHE RAJONALE

Menaxhmenti i UBT-së ka analizuar se në UBT do të ketë më shumë hulumtime dhe publikime shkencore, forume, takime ndërkombëtare, bashkëpunime rajonale e më gjerë, si dhe me universitetet ku flitet gjuha shqipe. “Bashkëpunimin e shoh në shumë fusha, si në këmbimin e literaturës, këmbimin e studentëve, përpilimin e literaturës së përbashkët, këmbimet e profesorëve, ligjërimin e lëndëve që lidhen me Kosovën p.sh. bashkëpunim në hulumtimin, zhvillimet ekonomike në trevat shqiptare dhe rajon dhe revistat e përbashkëta në lëmi të caktuara”, - tha prof. Li mani.

Nga të pranishmit në mbledhje u vendos që çdo muaj Këshilli Akademik të mbajë mbledhje.

Presidenti i UBT në krye të strukturave të AKB

Kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) edhe më tej do të mbetet Agim Shahini deri në kuvendin zgjedhor të radhës, ndërsa dy nënkryetarët e përzgjedhur janë presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT, Edmond Hajrizi si dhe Blerim Devolli,

të cilët do ta drejtojnë AKB në mandatin katërvjeçar.

Më tej Kuvendi i Pestë Zgjedhor i AKB ka përzgjedhur edhe 13 anëtar e Bordit Drejtues të AKB. Sipas z. Shahinit AKB në vitin 2002 ka pasur vetëm 32 anëtarë kurse sot ka 9500 anëtarë.



Bisedë me Prof. Werner Retschitzegger, ligjërues në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në UBT



Jeni shembull

Do të doja që të gjithë studentët e mi në Austri, të ishin aq të motivuar sikurse studentët në UBT. Universiteti për Biznes dhe Teknologji është definitivisht shumë i orientuar në të ardhmen, duke iu përshtatur me përsosmëri kërkesave të një ekonomie dhe shoqërie që po rritet shpejt. Prof. Werner Retschitzegger, flet për UBT News.



HEROLIND BEQAJ

UBT News: A mund të na thoni shkurtimisht diçka rreth vetes dhe angazhimeve tuaja profesionale?

Werner Retschitzegger: Kam studiuar informatikën e biznesit në Universitetin Johannes Kepler (JKU), në Linz të Austrisë. Kam kryer shkallën MS në vitin 1991 dhe PhD në vitin 1996, në Fakultetin e Biznesit, Ekonomisë dhe Shkencave Sociale (Venia Docendi) për shkencë kompjuterike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Inxhinierisë të JKU-së. Nga viti 1990 deri në 1993, kam punuar për Institutin e Procedimit të Njohurive të Aplikuara në Hagenberg, Austri, ku jam përfshirë në projekte të ndryshme nacionale/ ndërkombëtare dhe projekte kërkimore. Në vitin 1993, u përfshiva në Departamentin e "Information System" në JKU. Në vitin 2002, u emërova përkohësisht si profesor me orar të plotë për informatikën e biznesit në Universitetin Teknik të Vjenës. Nga 2003 - 2006 isha kryetar i Institutit të Bioinformatikës në JKU, nga 2008 - 2009 isha profesor mysafir në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Univer-



sitetin e Vjenës. Kam botuar më shumë se 140 shkrime në revista ndërkombëtare. Interesimet e mijë kërkimore përfshijnë inxhinierimin e të dhënave, inxhinierimin e rrjedhës së punës, inxhinierimin e ueb-it, inxhinierimin e modelit dhe inxhinierimin e ontologjisë si dhe zbatimin e tyre në sistemet e informacionit të turizmit, sistemet e menaxhimit të trafikut rrugor dhe uebin social. Aktualisht, kryesoj 'Information Systems Group' në JKU.

UBT News: Si e vlerësoni punën e bërë në UBT, veçanërisht në departamentin e Shkencave Kompjuterike? A jeni të kënaqur në përgjithësi me kushtet e ofruara në këtë universitet?

Retschitzegger: UBT është definitivisht një universitet shumë i orientuar në të ardhmen, i cili i përshtatet me përsosmëri kërkesave të një ekonomie dhe shoqërie që po rritet shpejtë, duke u përgatitur për një të ardhme të fokusuar në teknologji. UBT kombinon shumë nga përparësitë e një universiteti të ri dhe inovativ: fakultet me studentë shumë të motivuar, një infrastrukturë moderne dhe shkallë të lartë të teknologjisë.

Karakterit ndërkombëtar i programeve dhe klasat jo shumë të mëdha në UBT, ofrojnë një alternativë premtuese për të gjithë ata që kërkojnë një arsimim të lartë. Për më tepër, UBT ofron studime ndërkombëtare ndërdisiplinore, duke u siguruar studentëve vlera të larta intelektuale dhe profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Lidhur me departamentin e shkencave kompjuterike, reputacioni i cilësisë është padyshim synimi i përgjithshëm dhe konsiderohet si një përgjegjësi e rëndësishme për studentët. Anëtarët e fakultetit dhe stafi akademik nga një numër i vendeve të ndryshme të huaja, janë të kualifikuar e të motivuar, duke qenë gjithmonë të afërt me studentët. Duke e inkurajuar metodën e punës me grupe, një element kyç në arritjen e suksesit në të gjitha fushat është duke u promovuar. Veçanërisht karakteri i lëndëve të shkencave kompjuterike i orientuar në praktikë që ofrohet nga UBT është për t'u theksuar, sepse në këtë mënyrë i siguron studentëve një bazë të fortë për studime të mëtejshme, hulumtim dhe punësim në IT kompanitë inovative.

UBT News: Çfarë ju ka motivuar që të vini në Kosovë dhe të edukoni studentët e UBT-së?

Retschitzegger: Njohuria dhe përvoja është ajo që Kosovës i duhet më së shumti gjatë kësaj kohe të tranzicionit social dhe ekonomik. Edhe pse universitetet në Kosovë kanë kuadro të kualifikuara, sidomos kur e kemi parasysh rastin e UBT-së, një garanci e mëtejshme për cilësinë dhe suksesin është bashkëpunimi me stafin akademik nga vendet e huaja. Kjo është edhe strategjia e presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i cili është gjithashtu një ligjërues në Universitetin e Teknologjisë në Vjenë. Përmes ndërmjetësimit të kryetarit të Shoqërisë austriake të Kompjuterëve (OCG), Prof. Dr. Gerald Futschek, Prof. Dr. Hajrizi më ka ofruar një mundësi unike për të dhënë leksione në UBT disa vite më parë. Motivimi kryesor për vendimin tim për të edukuar studentët në UBT, ishte shkalla e lartë stafit akademik ndërkombëtar dhe ekspertëve të huaj në UBT. Përveç kësaj, arsimimi në shkencë kompjuterike ofron një sfond të fuqishëm teorik, ndërsa duke përfshirë një përqendrim të madh në aspektet praktike dhe aspekteve që mund të zbatohen nga të gjitha subjektet, përputhet plotësisht me kuptimin tim të edukimit në universitet me cilësi të lartë. Nëse duhet ta përmbledh, për mua është një nder që jam pjesë e "Ekipit UBT", duke dhënë kontributin tim modest për suksesin e UBT-së. Do të doja të shpreh mirënjohjen time të veçantë për Prof. Dr. Hajrizi, i cili më dha këtë mundësi.

UBT News: Çfarë mund të na thoni për nivelin e studentëve në UBT?

Retschitzegger: Jam thellësisht i impresionuar nga motivimi i pabesueshëm, të cilin e shfaqin studentët e UBT-së. Nëse flasim sinqerisht, do të doja që të gjithë studentët e mi në Austri, të ishin aq të motivuar. Do të doja të theksoj gjithashtu çiltërsinë e tyre për të hapur tema të reja dhe sfiduese në shkencë kompjuterike, pa marrë parasysh nëse ato janë të natyrës teorike ose praktike, ku përfitimi i të mësuarit është menjëherë i dukshëm.

UBT nxjerr ekspertë të Mekatronikës

“Mekatronika mësohet edhe në Kosovë”, “U hap laboratori i parë i Mekatronikës”, “Presidenti i UBT-së, E. Hajrizi solli Mekatronikën në Kosovë”, “Laboratori i Mekatronikës në UBT, i pari dhe i vetmi në Evropën Juglindore”. etj. Këta ishin titujt e mediave kosovare dhe atyre ndërkombëtarë pas hapjes së Laboratorit të Mekatronikës në UBT.

Mekatronika filloi që të zbatohet qysh në shekullin e kaluar në vendet më të zhvilluar në Botë. Tash kjo lëmi thuhet se ka përfshijë cep më cep të rruzullin tokësor. Për herë të parë kjo lëmi po zhvillohet edhe në shtetin më të ri në Evropë, Republikën e Kosovës, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). I pari i UBT-së, Edmond Hajrizi duke e parë se Mekatronika është çelës i zhvillimit të teknologjisë, është ndihmesë për ndërmarrjet prodhuese si private ashtu dhe publike, është ndihmesë për lehtësimin e punës për menaxherët e kompanive, etj etj, arriti që ta sjellë edhe në Kosovë. Duke e parë rëndësinë e mekatronikës, shumë shpejtë u rritën kërkesat në vend që të studiohet dhe përvetësohet kjo fushë.

LABORATORI I MEKATRONIKËS NË UBT, I PARI DHE I VETMI NË EVROPËN JUGLINDORE

Prezantimi i parë i mekatronikës në vendin tonë është bërë në hapjen solemne të Laboratorit të Mekatronikës në UBT. Aty është bërë i gjithë programi i mekatronikës për studime tre vjeçare dhe master. “Mekatronika mësohet edhe në Kosovë”, “U hap laboratori i parë i Mekatronikës”, “Presidenti i UBT-së, E. Hajrizi solli Mekatronikën në Kosovë”, “Laboratori i Mekatronikës në UBT, i pari dhe i vetmi në Evropën Juglindore”. etj. Këta ishin titujt e mediave kosovare dhe atyre ndërkombëtarë pas hapjes së Laboratorit të Mekatronikës në UBT.

Ky projekt u mundësua në bashkëpunimi të ngushtë midis UBT-së dhe Institutit për Udhëheqje dhe për Robotikë (IHRT) në Universitetin e Vjenës për Teknologji, Universitetin e Ēaterfordit për Teknologji (ISOL), Irlandë, me Laboratorin për Robotikë dhe Mekatronikë (LARM-UNIGAS), si dhe Universitetin e Cassinos në Itali. Ky projekt është zbatuar nga Komi-



sion Evropian më saktësisht nga TEMPUS. “Laboratori i mekatronikës në UBT, është i pari dhe i vetmi i këtij lloji në vende të Evropës Juglindore. Mekatronika është një fushë e re jo vetëm në Kosovë, por shumë e rëndësishme, interdisiplinare e cila do të ndikojë direkt në zhvillimin e ekonomisë dhe të industrisë në përgjithësi, si dhe në sigurimin dhe ngritjen e kualitetit të produkteve tona; ka thënë me rastin e hapjes së këtij Laboratori, Rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi.

BIZNESET DHE QYTETARËT E KOSOVËS TË KONKURROJNË NË TREGUN GLOBAL

Në vazhdimësi në UBT po mbahen konferenca shkencore për Mekatronikë. Pjesëmarrja dhe interesimi është shumë i madh sidomos nga ekspertë ndërkombëtarë, profesorë dhe përfaqësues të kompanive me përvojë nga fusha e Mekatronikës. Pjesëmarrës po ashtu janë edhe profesor vendor dhe studentë të të gjitha fakulteteve në UBT, përfaqësues të

Qeverisë të Kosovës dhe të ndërmarrjeve private. Ajo që i bën dhe i tërheq të pranishmit si studentët dhe menaxherët e kompanive në këto konferenca është prania e ekspertëve nga shtete të ndryshme të zhvilluar, pasi që nga ata po marrim përvojë dhe njohuri të reja, të cilat pastaj zbatohen në vendet e punës dhe fakultete.

“KOSOVA GO INTERNATIONAL- DITA E AUTOMATIKËS”.

Kjo konferencë u mbështet nga programi TEMPUS si dhe Universitete e institucione ndërkombëtare partnere, si Universiteti i Vjenës për Teknologji, Instituti i Waterfordit për Teknologji nga Irlanda si dhe Universiteti i Cassinos nga Italia. Gjithashtu një kontribut të veçantë në këtë konferencë dhanë edhe disa nga kompanitë botërore me përvojë në fushën e Mekatronikës dhe Robotikës si FESTO, KEBA, Frequentis GmbH, të cilat sollën përvojat dhe modelet e fundit të teknologjisë së Mekatronikës. Po i citoj vetëm disa pjesëmarrës të konferencës. Në hapjen të kësaj konference rektori i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi tha: “Kosova, sot më shumë se kurrë ka nevojë për shkëmbimin e praktikave me vende dhe kompani lider në fushën e teknologjisë, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të procesit të prodhimit si dhe ofrimit e mundësive për studentët dhe industrinë kosovare që të jenë gjithnjë në hap me trendet e zhvillimit ndërkombëtar të teknologjisë”.

Profesori Peter Kopacek nga Instituti për Manovrimin e Pajisjeve dhe Robotëve nga Universiteti i Vjenës për Teknologji, ligjëroj në temën Menaxhmenti i Mekatronikës, një fushë e re e dijës, e cila sipas Kopacek ofron 70 përqind njohuri mbi teknologjinë dhe 30 përqind mbi biznesin. Ai tha se së bashku me Universitetin për Biznes dhe Teknologji po zhvillojnë një pro-

gram studimi në këtë fushë, i cili do t'iu mundësoj qytetarëve të Kosovës të marrin njohuri të kombinuara mbi teknologjinë dhe biznesin në të njëjtën kohë. Duke folur në të njëjtën temë, profesori Larry Stapleton nga Institutit i Ëaterfordit për Teknologji tha se njohuritë e përfituara nga programi i studimeve për Menaxhment të Mekatronikës do të kenë aplikim përveç tjerash edhe në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve me të cilat Kosova është mjaft e pasur, si dhe do të krijojë kuadro vendor të cilët do të mund të zhvillojnë aktivitetet ekonomike të vendit pa pasur nevojë për ekspertizë nga jashtë në fazat e mëvonshme. Ideja kryesore e këtij programi, tha Stapleton është që të ndërtohen biznese nga qytetarët e Kosovës, por të cilat do të kenë mundësi të konkurrojnë në tregun global.

Menaxheri për Evropën Juglindore në kompaninë FESTO nga Ljubljana, Stanislav Bercic prezantoi disa nga aktivitetet e kësaj kompanie duke u ndalur kryesisht në aplikimin e teknologjive Mekatronike në industri. Për sa i përket ndërledhjes së kësaj fushe me edukimin, ai tha se ekziston një sistem dual i edukimit në këtë fushë që nënkupton arsimimin në shkollë si dhe kombinimin tij me aplikimin në vendin e punës. Për t'u bërë funksional ky sistem, duhet mësim gjatë gjithë jetës, theksoi Bercic.

Walter Schimpelsberger, menaxher i shitjes në divizionin e automatikës industriale në kompaninë KEBA prezantoi produktet dhe teknologjitë që ofron kjo kompani të cilat kanë aplikim në shumë fusha të industrisë, sidomos në atë të automobilave, të ushqimit etj. Ai tha se KEBA ofron zgjidhje optimale, me kompetencë dhe fleksibilitet të lartë, sidomos në mundësinë për të optimalizuar përdorimin e robotëve në çdo lëmi të industrisë.

EKIPI "SKËNDERBEU"

Vullneti dhe motivimi dhe për ta zhvilluar këtë lëmi në Kosovë dhe në mënyrë që edhe Kosova të jetë në hap me botën e moderne, rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi me studentët të UBT formoi ekipin e futbollit të robotëve "Skënderbeu". Pas një kohe të

shkurtër, ky ekip mori pjesë në Kampionatin Evropian të Robotëve të Futbollit që u mbajt në Zvicër dhe Austri, duke e prezantuar kështu për herë të parë Republikën e Kosovës. Edmond Hajrizi, së bashku me studentët e vet dhe ishin në hapjen solemne të kampionatit evropian. Në këtë kampionat morën pjesë shumë shtete nga Evropa dhe bota, ndërsa drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes ka qenë edhe Driton Latifi, gazetar i së përditshmes "Lajm". "Robotët kosovarë në evropian", shkruante "Lajmi", "Kosova përmes UBT përfaqësohet në një ngjarje të tillë të karakterit ndërkombëtarë", shkruan gazeta "Epoka e re", "UBT përfaqëson Kosovën në kampionatin Evropian të Futbollit për Robotë", shkruan "Infopress".

RINIA E KOSOVËS NË RRJEDHAT E ZHVILLIMIT TË TEKNOLOGJISË MODERNE

"Pas një viti e gjysmë pas pavarësimit të Republikës së Kosovës, Kosova fiton të drejtën zyrtare që të organizoj një ngjarje të tillë, që ka karakter dhe njohje ndërkombëtare të arritjeve shkencore profesionale, në teknologjinë e fundit që ka Kosova, e veçanërisht në sport", ka thënë rektori Edmond Hajrizi në hapjen solemne të kampionatit Evropian të robotëve që luajnë futboll që u organizua në Kosovë pikërisht në UBT. Ky ishte kampionati i parë i këtij lloji i organizuar në Evropën Juglindore. Në ceremoninë e hapjes së kampionatit morën pjesë përfaqësueset të Republikës së Kosovës, profesor e ekspertë ndërkombëtarë, përfaqësueset të kompanive dhe të të biznesit, mediat vendore dhe ndërkombëtare. Me fjalë rasti, hapjen e patën përshëndetur ministri i Sportit, Valton Beqiri, prof. dr. Petar Kopacek nga Universiteti i Vjenës për Teknologji, që është njëkohësisht edhe nënkryetar i FIRA-s, dhe udhëheqës i FIRA-s për Evropën. "E veçoj këtë ditë, e veçoj këtë sport. Kjo është ditë e madhe për Kosovë, është një datë që do të shënohet në histori. UBT-ja ka bërë punë të çmueshme me organizimin e këtij kampionatit", tha ministri Beqiri.

Kosovën e përfaqësoi ekipi "UBT Kosova". Turne në fjalë vazhdoi tri ditë

më radhë dhe u zhvilluan mbi 30 lojë. Objekti i UBT ishte mbushur përplot tifoz të sportit, si vendor ashtu edhe ndërkombëtarë. "Luaj futboll për ekipin "Independent" në Gjermani, para dy ditë jam njoftuar se në Prishtinë, në UBT po mbahet 'Eurby 2009', erdha ta shikoj lojën, kjo është dëshmia që Universitetet private janë ka punoj drejt teknologjisë më moderne që ka bota", tha një pjesëmarrës nga Gjermania. Po ashtu prezent dhe një kontribut mjaft të rëndësishëm dhanë mediat vendore si të shkaruar ashtu edhe ato vizuale. Po citojmë vetëm disa tituj të gazetave ditore. "Kosova hynë në Histori" shkruan gazeta "Sport", "Euroby 2009" sjell në Prishtinë të paktën shtatë shtete", shkruan gazeta "Express", "Kosova nikoqire e evropianit për robot", shkruan gazeta "Koha Ditore". Sponsor të Kampionatit evropian të futbollit me robot ishin edhe RTK, gazeta "Lajm", Kompania "IPKO", "Rrota", etj.

MENAXHERË PËR KOMPANI VENDORE

Siç dihet në Kosovë mungon kuadri ligjërues vendor, por kjo nuk është hetuar në UBT. Besoj se edhe në të ardhmen nuk do të ketë mungesë të profesorëve, sepse dihet se UBT-ja njihet si Universitet Ndërkombëtarë dhe ka marrëveshje me shumë universitete më prestigjioze në botë. Në fillimin e viti akademik 2009/2010, rektori i UBT-së, Edmond Hajrizi mbajti një takim më të gjithë menaxherët e ndërmarrjeve private si "Llokumi", "Buqaj", "Kafës" etj, dhe me anëtarët e AKB-së. "Më është prishur makina që prodhon, më është dashur të shkoj në Gjermani të marr një ekspert për dy orë punë që kushtoi 2 mijë euro, plus shpenzimet e tjera", tha X menaxheri. Menaxheret janë të njoftuar se një specialis i Mekatronikës sa është i nevojshëm për kompaninë prodhuese, dhe në përfundim të takimit më një marrëveshje gojore, u tha se të gjithë studentët që studionin Mekatronikën në UBT do punësohen dhe do të kontribuojnë për kompaninë në fjalë.

Temën e punuan studentët të vitit I,

Fakulteti Mekatronikë në UBT:

Kreshnik Ismaili, Veprim Mustafa,

Fidan Bujupi, Arjan Agani, Granit Ramadani

Bisedë me dr. Robert Pichler, ligjërues në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT

UBT është ndryshe

Është ndryshe të ligjëroni në UBT, në krahasim me universitetin tim amë apo në shkolla të tjera në Bashkimin Europian sepse këtu dëshira dhe motivimi për të mësuar e arritur sukses janë shumë të forta. Kosova është vendi më i varfër në Europë, por kosovarët e rinj do të ndihmojnë përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit". Prof. Robert Pichler flet për UBT News.

NAILE DEMIRI

UBT News: Zotëri profesor si e vlerësoni punën që bëhet në UBT, e veçmas në degën e biznesit degën ku ligjëroni ju? A jeni i kënaqur me kushtet që ofrohen në këtë universitet në përgjithësi?

Pichler: Studentët janë të motivuar dhe niveli i shkathhtësive (gjithashtu edhe i anglishtes) është i shumë mirë. Po ashtu organizimi dhe administrimi në UBT është modern.

UBT News: Nga UBT-ja kanë dalë biznesmen të mëdhenj (të cilët menaxhojnë kompanitë më të mëdha publike dhe private ne vend dhe jashtë vendit), kur kemi parasysh se studentët këtu aftësohen nga kuadrot me renome, siç jeni edhe ju. Profesor, çfarë ju ka motivuar të vini në Kosovë ta shkolloni dhe ta aftësoni një kuadro të tillë?

Pichler: Është ndryshe të ligjëroni në UBT në krahasim me universitetin tim amë apo në shkolla tjera në Bashkimin Europian. Dëshira dhe motivimi për të mësuar dhe arritur sukses janë shumë të forta në UBT, i cili gjithashtu nga ana e tij, siguron motivim shtesë për ligjëruesit që të jenë pjesë e këtij procesi.

UBT News: Si i vlerësoni proceset ekonomike ne Kosove dhe ku gjendet Kosova ne këtë aspekt ne krahasim me shtetet tjera?

Pichler: Të dhënat statistikore tregojnë se Kosova është vendi më i varfër në Europë. Natyrisht, ka shumë potencial për të vazhduar dhe për të përmirësuar proceset që kanë filluar. Universitetet, edhe UBT në mesin tyre, janë një shteg premtues për edukimin e gjeneratës së re të koso-



varëve të rinj që do të ndihmojnë përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit.

UBT News: Cilat duhet të jenë prioritet kryesorë të Qeverisë së Kosovës për të rritur zhvillimin ekonomik?

Pichler: Një sistem ligjor që mbështet iniciativat e biznesit dhe që lufton korrupsionin e praktikën e paligjshme në përgjithësi. Investitorët duhet të sigurohen se angazhimi i tyre në Kosovë është i sigurt.

UBT News: Çfarë mund t'i sjellë Kosovës anëtarësimi në Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe institucionet tjera ndërkombëtare financiare?

Pichler: Standardet ligjore që janë në përputhje me këto institucione.

UBT News: Çfarë duhet bërë institucionet tona për të gjeneruar vende të reja pune, dhe për të

rritur punësimin?

Pichler: Gatishmëria për të rrezikuar, për të investuar pandërprerë me synimin e rritjes dhe zgjerimit. Kjo në fund do të krijojë vende të reja pune sipas mendimit tim.

UBT News: Dihet se Kosova eksporton shumë pak ndërsa importon shumë më shumë. Çfarë duhet të bëjë shteti ynë që të rritë eksportin?

Pichler: Në mënyrë që të jetë tërheqëse për vendet e huaja, Kosova duhet të prodhojë mallra dhe shërbime, ku vendi ka një përparësi konkurruese. Për sa kohë që kjo përparësi nuk është e qartë për vendet e huaja, eksporti do të jetë i vështirë.

UBT News: Si e shihni ekonominë botërore për vitin 2010?

Pichler: Ekonomia botërore ngadalë po rikuperohet, por papunësia do të rritet ende.

Konsumoni prodhime vendore

FILLORETA HASANI

viti I, MBE, UBT

Prodhimet vendore ende vazhdojnë të injorohen dhe të mos konsumohen nga qytetarët e Kosovë. Rezultojnë pasuksese të mëdha edhe fushatat e ndryshme kundër produkteve serbe dhe disa organizatave tjera joqeveritare. Asnjë qeveri nga pas lufta nuk ka menduar seriozisht që ti bind qytetarët ti konsumojë produktet vendore, qytetarët ende e kanë një dozë dyshimi se produktet vendore nuk janë të cilësisë së lartë në krahasim me ato të importit. Mos konsumimi i prodhimeve vendore e dëmton ekonomin dhe buxhetin e Kosovës. Përfaqësues të biznesit thonë se e kanë rrit kualitetin në mas të madhe por sipas tyre duhet ende një fushatë edhe më e madhe që ti bind qytetarët ti konsumojnë prodhimet vendore. Për të aritur ti bindim qytetarët se vërtet duhet konsumuar prodhimet vendore duhet ne radhë të parë të stimulohen prodhuesit vendor në uljen e taksave që do ishte një parakusht i kostos më të lirë në treg. Konsumatori ynë në gjendjen aktuale që jemi nuk e qanë fort kokën çfarë është duke konsumuar por i intereson vetëm të konsumoj atë që e




Është më mirë që të konsumohen prodhimet vendore se sa ato që nuk dimë ku dhe si prodhohen. Konsumimi i prodhimeve vendore është edhe një ndihmesë për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, krijimin e vendeve të punës, si dhe shumë përfitimeve të tjera për vendin tonë.

gjen me çmim më të lirë se me të ardhurat që ka është shumë larg kualitetit.

Për kundër këtyre edhe faktori kualitet mungon në prodhimet tona vendore nga se në mungesë të teknologjisë së përparuar vështir arrihet deri te kualiteti.

Pasojat e konsumimit të prodhimeve pa ua ditur origjinën do i vërejmë pas disa viteve por ajo që aktualisht mund të bëhet është të shtohet kontrolli i inspektorëve sanitar për cilësinë e këtyre produkteve. Si do që të jetë është më mirë që të konsumohen prodhimet vendore se sa ato që nuk dimë ku dhe si prodhohen. Konsumimi i prodhimeve vendore është edhe një ndihmesë e zhvillimit të ekonomisë së mesme të Kosovës, krijim i vendeve të punës dhe përfitime tjera që ka në tërësi shteti i porsakrijuar Kosova. Në aktualitetin e tanishëm është vështirë të injorohen tërësisht prodhimet jovedore por me një përkushtim të shtuar ekzistojnë mundësit e hulumtimit të prodhimeve nga shtetet që aktualisht e kanë njohur Kosovën. Në anën tjetër tregtarët për tu ikur prodhimeve të importuara duhet tu mundësohet ulja e tatimeve dhe kontrolli më i shtuar nga organet kompetente .

Studimet bachelor në UBT, master në Politecnico Di Milano



“Qëllimi im kryesor do të jetë, që gjithë eksperiencën e arritur ta aplikoj në Kosovë”, thotë Leana Mahmuti, e cila para dy viteve ka përfunduar studimet themelore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), Departamenti Arkitekturë, e tash në prag të përfundimit të studimeve Master në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Itali, drejtimi Arkitekturë, dhe është në hulumtim e sipër nëpër universitete më prestigjioze në Evropë për studime të mëtuqjeshme.

“Bazuar në suksesin e arritur gjatë dhe pas përfundimit të studimeve bach-

elor në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, më është ndarë bursa në Universitetin "Politecnico Di Milano", ku jam duke përfunduar studimet për master”, thotë Leana, e cila përpos studimeve punon në profesion që ka, punon në një byro projektuese në Como (qytet në veri të Milanos), një qytet shumë të qetë, i bukur dhe me monumete shumë të vjetra dhe historike. Leana kolegëve të UBT-së ju drejtohet me këtë mesazh. “Secili prej kolegëve të mi apo studentët e UBT-së, mund të arrijnë sukses në profesion, me përkushtim dhe punë”, përfundon ajo.

Qendra Gjenetike

Qendra Gjenetike e Kosovës për mbarsim artificial të gjedheve është një projekt që realizohet si donacion nga Qeveria Italiane. Misioni i qendrës është që të prodhojë doza të mjaftueshme dhe shumë kualitative të racave më të njohura në botë të gjedheve në mënyrë që t'u mundësojë fermerëve vendorë të kultivojnë raca shumë mirë të studiuara, për të rritur kualitetin dhe kuantitetin e qumështit dhe prodhimeve të tij, si dhe për të rritur kualitetin dhe kuantitetin e mishit.



LULZIM BEQIRI

Qendra Gjenetike e Kosovës për mbarsim artificial të Gjedheve është një projekt që realizohet si donacion nga Qeveria Italiane, konkretisht Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë, përmes OJQ-së italiane PRO.DO.C.S me seli në Romë, respektivisht degës së saj në Pejë dhe përfaqësuesit-Prezidentit të PRO.DO.C.S-it në Romë-Ana Maria Donnarumma dhe përfaqësuesit në Pejë Z. Marco Piccolo-Menaxher i projektit.

Projekti do të implementohet në tokat e Institutit të Bujqësisë në Pejë të destinuar nga ministria e bujqësisë për ndërtimin e kësaj qendre (respektivisht në Arbresh-Vitomiricë) që ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës.

Projekti deri në fazën e implementimit ka kaluar nëpër faza të ndryshme të konsultimeve që i ka

bërë udhëheqësi i projektit Z Marco Piccolo me Ministrinë e Bujqësisë në Prishtinë, Institucionet Komunale në Pejë, konsulentët e jashtëm (Profesor Dr.sci Xhavit Bytyçi - profesor në fakultetin e Veterinës në Universitetin e Prishtinës; MSc. Lulzim Beqiri - arkitekt; Ekspertin e qendrave gjenetike Z. Ugo Cavallini nga Italia etj.).

Për kompletimin e projektit është zgjedhur Shtëpia Projektuese "archART" në bazë të një procesi selektues që është bërë nga OJQ-PRO.DO.C.S në Pejë dhe e njëjta do t'i përcjellë edhe punimet gjatë implementimit si donacion për Qendrën e parë Gjenetike për mbarsim artificial të gjedheve.

MISIONI

Kosova më herët ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë dhe si e tillë të gjitha nevojat e saj sa i përket mbarsimit ar-


tificial të kafshëve janë plotësuar nga ish-federata jugosllave, në të cilën kanë ekzistuar qendra gjenetike.

Me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe me krijimin e Kosovës shtet të pavarur është krijuar nevoja që të ndërtohet një qendër gjenetike për mbarsim artificial të gjedheve pasi që këto kafshë janë me numër të madh në Kosovë.

Misioni i qendrës është që të prodhojë doza të mjaftueshme dhe shumë kualitative të racave më të njohura në botë të gjedheve në mënyrë që t'u mundësojë fermerëve vendorë të kultivojnë raca shumë mirë të studiuara, për të rritur kualitetin dhe kuantitetin e qumështit dhe prodhimeve të tij, dhe gjithashtu për të rritur kualitetin dhe kuantitetin e mishit.

Misioni i qendrës gjenetike do të jetë në të ardhmen që të bëjë studime në vazhdimësi të racave që i përshkruajnë kushtetona klimatike dhe përmirësime gjenetike në favor të rrit-

e Kosovës



jes së cilësive të lartpërmendura.

VIZIONI

Kosova duke shfrytëzuar kapacitetet e veta intelektuale dhe përvojën ndërkombëtare, synon që të ketë një qendër shumë mirë të njohur në rajon edhe më gjerë, sepse qendra është e konceptuar në atë mënyrë që të prodhojë doza të mjaftueshme për mbarsim artificial të gjedheve, për fermerët vendor por edhe për fermerët e rajonit. Duke pasur parasysh perspektivën Europiane të Kosovës, rrezja e furnizimit të kësaj qendre do të rritet dhe kjo do të jetë qendër rajonale për studime gjenetike dhe prodhim të dozave cilësore.

LOKACIONI

Lokacioni është zgjedhur të jetë pjesa perëndimore e Kosovës, konkretisht Peja sepse në këtë qytet është edhe instituti për kërkime bu-

jqësore që ka sipërfaqe të mjaftueshme për ndërtimin e qendrës Gjenetike për mbarsim artificial të gjedheve.

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit nga ministria e bujqësisë, nga tokat e Institutit bujqësor janë dhënë sipërfaqe prej 10 hektarëve ku do të ndërtohet qendra (në sipërfaqe prej përafërsisht 1 hektar) dhe pjesa tjetër do t'i shërbejë qendrës për kultivimin e bimëve ushqyese për demat dhe viçat.

Lokacioni i qendrës është shumë pranë rrugës magjistrale në mes të Pejës dhe Mitrovicës që i mundëson klientëve të qendrës të kenë qasje shumë të lehtë deri te qendra, ndërsa fakti që qendra është e vendosur në tokat e Institutit bujqësor nënkupton që hulumtimet në këtë qendër do të jenë shumë më profesionale dhe të nivelit të lartë akademik sepse Instituti ka një qasje shumë të mirë me qendrën.

Duke pasur parasysh se lokacioni i qendrës është në zonën periferike të qytetit të Pejës, e larguar nga zona industriale e Pejës do të thotë që qendra është mirë e izoluar dhe e mbrojtur nga infeksionet që mund të përcillen përmes rrymimit të ajrit.

Natyra hulumtuese dhe prodhuese e qendrës dhe kushtet shumë të izoluar që ofron lokacioni, bën që kjo qendër të cilësohet si shumë mirë e inkomparuar në lokacionin që është i destinuar për të dhe funksionin që do ta ketë.

Vendosja e qendrës në pjesën perëndimore të Kosovës, në Pejë nuk është në pozitë qendrore në Kosovë, mirëpo duke marrë për bazë se Qendra do të ketë një kapacitet që tejkalon nevojat e Kosovës është paraparë që të jetë një qendër rajonale edhe për shtetet rreth Kosovës.

KONCEPTI ARKITEKTONIK

Në objektet bujqësore, për shkak të koston dhe funksionit nuk ka ndonjë domosdoshmëri të konceptit arkitektonik të formësimit të objektit sikurse

në objektet me destinim tjetër (p.sh. hotelet, banesat, shkollat, spitalet etj) . Prandaj koncepti arkitektonik është në funksion të funksionalitetit të kësaj qendre duke pasur edhe ndikim nga kostoja për implementim.

Megjithatë vendosja e objekteve, formave dhe funksioni i brendshëm i tyre është i konceptuar me kujdes, që kanë bërë që kjo qendër të jetë shumë funksionale dhe me të gjitha standardet e kërkuara për kushtet e Kosovës.

KONSTRUKSIONI

Për qendrën gjenetike është përdorur sistemi skeletor (me shtylla dhe traje) . Ky sistem i mundëson qendrës që më vonë të ketë modifikime të ndryshme varësisht nga zhvillimet teknologjike dhe pajisjet që do të përdoren në këtë qendër. Ky sistem i ndërtimit i mundëson qendrës që të ketë zgjerime varësisht sipas nevojës dhe kërkesave.

FUNKSIONI

Vendosja e objekteve në lokacion është bërë për t'iu përshtatur funksionit që e kanë objektet. Hyrjet gjithashtu janë konceptuar në atë mënyrë që të bëhet evitimi i gërshetimit të pjesës për furnizim dhe asaj për distribuim të produktit. Edhe objektet në mes veti janë funksionalisht shumë mirë të lidhura që ndikojnë në shkurtrimin e qasjeve në aspektin funksional të objekteve në mes veti.

IMPLEMENTIMI

Projekti do të implementohet në dy faza.

Implementimi i projektit ka filluar në dhjetor nga kompania "Çeta GIG" nga Peja dhe pritet të përfundojë rreth muajit qershor dhe mandej fillon faza e dytë e implementimit.

Në fazën e parë do të ndërtohet laborator, shtalla e demave, depoja për koncentrat, sanë dhe deponia e plehut ndërsa në fazën e dytë do të ndërtohet shtalla e viçave, shtalla për testimin e viçave-Karantina, garazhi dhe asfaltimi i rrugëve që në fazën e parë janë të punuar me zhavorr.

Autori është mësimdhënës në UBT dhe Menaxher i zhvillimit të projekteve

Bisedë me Prof. dr. Rexhep Gjergji, ligjërues i matematikës në UBT

UBT është kampion

Ndihet i nderuar që është pjesë e UBT-së, prej themelimit të këtij universiteti. Thotë se përparësitë e UBT-të në raport me universitetin publik, por edhe me universitetet e tjera private, janë të dukshme. Beson se UBT do të zhvillohet edhe më shumë, duke e zënë një vend në mesin e universiteteve më të njohura në botë. Prof. Rexhep Gjergji, flet për UBT News.

HEROLIND BEQAJ

UBT News: I nderuar profesor, ju jeni nga ligjëruesit e parë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Si e vlerësoni e UBT-në në përgjithësi nga dita e parë e deri më sot?

Rexhep Gjergji: Së pari ju falënderoj shumë për mundësinë që po me jepni që të them edhe unë diçka për Universitetin për Biznes dhe Teknologji, pjesë e të cilit jam që nga themelimi i tij. UBT u imponua me seriozitetin e projektit që me rastin e aplikimit për licencë, duke ofruar programe serioze studimi dhe partner të fuqishëm ndërkombëtar që premtorin sukses dhe cilësi. Vitet e punës në vijim e dëshmuar këtë. UBT nisi dhe vazhdon të jetë kampion i promovimit të vlerave të larta akademike, me cilësi të lartë në studime dhe në kërkim shkencor. Në vitet e para të punës, kur programet studimore ishin vetëm në gjuhën angleze, në UBT ishin të angazhuar profesorë eminent nga universitete të njohura botërore. Ata mbajnë meritën e promovimit të standardeve të larta akademike në UBT. Unë isha i nderuar që isha pjesë e një stafi të tillë profesorësh nga elita botërore në fushat e veta të studimit. Shumë nga ta edhe sot vazhdojnë të jenë pjesë e UBT-së, ndërkohë që UBT vazhdon të krijojë stafin e vetë akademik, sipas kërkesave të ligjit. Natyrisht, kjo nuk do të arrihej pa një vizion të qartë dhe shumë pozitivist të themeluesit dhe rektorit të UBT-së, Prof. Edmond Hajrizit.

UBT News: Si e vlerësoni nivelin e studentëve, të cilëve u ligjëroni në UBT?

R. Gjergji: Niveli i studentëve që

vijnë për të studiuar në UBT reflekton nivelin e përgatitjes që ata marrin në shkollën e mesme, e cila në shumë aspekte lë për të dëshiruar.

Megjithatë, ajo që UBT ofron gjatë viteve të studimit të tyre mundëson që shumë nga ata të dalin kuadro të zotë për punën që ata e bëjnë pas studimeve. Shumë nga ata po bëjnë karrierë të suksesshme. Numri i të punësuarve nga të diplomuarit e UBT është i një shkalle shumë të lartë. Edhe pse në Kosovë tregu i punës nuk është aq i zhvilluar, megjithatë mirë i ka hetuar kualitetet e të shkolluarve në UBT. Por duhet thënë se në UBT vijnë edhe shkollarë nga shkolla e mesme shumë të përgatitur. Angazhimi i tyre dhe përgatitja e tyre për studim është për lakmi. Nuk duhet harruar që në UBT bëhen studime edhe pa shkëputje nga puna. Studentët që kanë këtë status, edhe pse kanë vende të mira pune, e kanë vlerësuar si të dobishëm

studimin në UBT, në mënyrë që të avancojnë në karrierë, të bëjnë punë edhe më të dobishme për vetën e tyre dhe për vendin e tyre, Kosovën.

UBT News: Çfarë mendoni se duhet te përmirësohet?

R. Gjergji: Nga përvoja ime që sa vite në UBT, kam konstatuar që standardet e larta të studimit dhe kërkesat e profesorëve në UBT nuk përballohen me sukses nga një numër studentësh që nuk e kanë përgatitjen e nevojshme për studime. Prandaj, që të evitohet kjo "dobësi", e në mënyrë që të rritet shkalla e kalueshmërisë, jam i mendimit se duhet ngritur niveli i kërkesave të dijes në provimin pranues. UBT ka investuar shumë që këtë mungesë ta evitojë, duke ofruar kurse shtesë të studimeve nga matematika dhe nga gjuha angleze, por duket se kjo për disa studentë nuk është e mjaftueshme.



UBT News: Cilat janë përparësitë e UBT, p.sh karshi Universitetit publik?

R. Gjergji: Gjithkund veprimtaritë private po tregohen më të suksesshme dhe më lehtë e më mirë të menaxhueshme. Kjo po tregohet edhe me universitet private. Për sa i përket UBT, avantazhet e tij në raport me universitetin publik, por edhe me universitet tjera private, janë të dukshme. Duke filluar nga standardi i dijes që u jepet studentëve, nga stafi akademik i angazhuar në UBT, nga shkalla e punësimit të të diplomuarve dhe suksesi i tyre në punën që pastaj bëjnë, suksesi i treguar nga një numër syresh në studimet të mëtejshme jashtë vendit, janë storie e suksesshme. Madje kushtet fizike të studimit në ambiente tejet komfore janë pakrahasimisht më të mira se të UP. Madje unë do të thosha se në shumë aspekte UBT është kampion edhe në rajon e ndoshta edhe më gjërë. Sikur prurjet nga shkollat e mesme të ishin më solide ujë jam i bindur se jehona e UBT do të ishte akoma më e madhe.

UBT News: Si e shihni të ardhmen e këtij institucioni?

R. Gjergji: Unë jam i bindur se vështirësitë e fillimit janë kaluar. Madje edhe qëndrimi jo shumë miqësor i pushtetit në raport me UBT duket se është zbutur paksa. Tanimë UBT ka një staf akademik të konsoliduar, ka partner shumë të fuqishëm ndërkombëtar që e lakmojnë edhe shumë universitete me traditë. UBT ka stabilizuar në masë të madhe shërbimet që marrin studentët në administratë, ka ndërtuar partneritet të konsoliduar me numër jo të vogël biznesesh. Mbi të gjitha në UBT nuk është ndier asnjëherë fryma e uljes së kriterit në vlerësim me qëllim të thithjeve më të mëdha të studentëve të rinj, sikur fatkeqësisht po bëjnë shumë nga universitetet private në Kosovë. Përkundrazi, kriteret rigorozë të vlerësimit dhe të dhënies së dijes e kanë karakterizuar dhe vazhdojnë ta karakterizojnë UBT. Këto janë garanci të mjaftueshme se UBT do të zhvillohet në një universitet serioz dhe do të zë vend në mesin e universiteteve të njohura në botë.

Përmbytjet në rrethinën e Shkodrës, pasojat ekonomike

Sipas ekspertëve financiarë të administratës shtetërore të Shqipërisë, dëmet në sektorë të ndryshëm të jetës së vendit kanë arritur në total 66.1 milionë euro, ose 9.1 miliardë lekë të reja.

NORA HASANI

Qarku i Shkodrës ishte në prag të një katastrofe natyrore duke u përballur me një situatë kritike për shkak të përmbytjeve nga shkarkimet e hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës. Situata u përkeqësua edhe më tej nga reshjet e shiut, të cilat vazhduan pareshtur. Në rrethinën e Shëngjinit dhe në Lezhë, batica detare kishte përmbytur shumë fshatra që gjenden pranë detit. Situata problematike ishte edhe në ishullin-Lezhe, pikërisht në zonën e Kënetës, në fshatin Tale dhe Fushe-Kuqe ne Kurbin, zonën e nën Shkodrës ne komunën e Dajcit ku situata nga përmbytjet ishte vërtetë katastrofale dhe evakuimi i banoreve haste në rezistencën e tyre. Burimet zyrtare nga Drejtoria e Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë pohuan se janë shkaktuar dëme të mëdha për shkak të shkarkimit të ujërave të HEC (hidrocentraleve) si dhe për shkak të reshjeve dhe shtrëngatave të shiut që vazhduan pa ndërprerje në gjithë Shkodrën. Shifrat nga ky burim zyrtar pohojnë se ishin zhytur nën ujë 10 mijë e 400 hektar tokë dhe 2500 shtëpi banimi, ndërsa u evakuuan 4800 persona. Në operacion më të madh humanitar të bërë ndonjëherë u angazhuan 800 forca ushtrie, 611 punonjës policie, 110 personel shëndetësor si dhe 115 forca nga Garda e Republikës. Në ndihmë të përmbyturve ndihmuan Italia, Mali i Zi, Austria, Greqia, Kosova, Maqedonia, Franca etj. Përmbytjet e shkaktuara nga reshjet dhe vërshimet e mëdha që rriten në dhjetëra e dhjetëra herë prurjet në lumenjtë e Matit, Drinit të Zi, Drinit të Bardhë, dhe degëve të tyre në lumin e Gashit, Valbonës, Curras dhe në lumin e Shalë, sollën shkatërrimin e prodhimeve bujqësore me 10% e prodhimit vendas, potencialisht dëmi bujqësor në zonën e Shkodrës për llogaritë i lartë pasi Shkodra zë rreth 6.8% të prod-



him kombëtar të drithërave, 9% të perimeve, 2.3% të patateve, 6% të frutave, 5.2% të rrushit. Përmbytjet kanë efekt edhe tek bizneset pasi Shkodra ka numrin më të madh të fermave bujqësore që blejnë farën në treg me rreth 15% të fermave në nivel vendi, dhe renditet si zona e dytë në numrin e fermave që blejnë sasinë më të madhe të plehrave kimike. Sipas të dhënave sipërfaqja e përmbytur në zonën e Shkodrës është 4816 ha tokë, zona të cilat nisin që nga periferia ku përfshihen dhjetëra fshatra të shtatë komunave. Orenditë shtëpiake janë të papërdorshme, serat e fermerëve u shkatërruan, e po ashtu edhe të mbjelat, bazat ushqimore për blegtorinë dhe shpendët është kalbur e gjitha, ndërsa shtëpitë janë pothuajse të pabanueshme, po ashtu kjo zonë kanoset nga rreziku i përhapjes së ndonjë epidemie nga mijëra shpend dhe kafshe të ngordhura që ndodhen rrugëve dhe në tokat e banorëve. Pas tre mijë shtëpive të dëmtuara, si dhe mbi 10 mijë hatokë të përmbytura, dëmi duket se do të kalojë shifrën 20 milion euro, sipas eksperteve financiarë të administratës shtetërore dëmet në sektorë të ndryshëm të jetës së vendit kanë arritur në total 66.1 milion euro, ose 9.1 miliardë leke të reja. Brenda pak ditësh çmimet për prodhimet bujqësore dhe blegtorale vendase janë rritur deri 11%, gjë që sollën pasojat në inflacion. Ndërkohë zyrtarët shtetëror pohojnë se objektiv i tyre është të mbajnë inflacionin në kufijtë e 4% dhe menaxhimin efikas të kostove. Kjo situatë e vështirë kaloi pa humbje jetësh dhe me dëme plotësisht të kompensueshme.

Përparësitë e shkollimit

Përparësitë e shkollimit të lartë privat janë dukshëm më të mëdha sesa ato të shkollimit publik. Në kolegjet private ekziston një frymë e re studimi, sistemi është pro-perëndimor dhe synon të jetë aplikativ. Çdo kolegji privat në Kosovë, energjinë e vet punuese e drejton kah studenti me tendencën që ta përshtatë atë për tregun e vogël kosovar dhe tregun e madh evropian.

AGRON R. BERISHA

UBT / Shkenca Kompjuterike, viti I

"All who have meditated on the art of governing mankind have been convinced that the fate of empires depends on the education of youth."

Aristotle

Shkollimi është liri dhe e drejtë e popujve të botës. Në vendet demokratike kjo e drejtë garantohet edhe me Kushtetutën e vendit përkatës. Në shumë shoqëri perëndimore shkollimi i ultë dhe i mesëm është i obliguar. Tek ne, kohët e fundit, shkollimi fillor është bërë i obligueshëm me ligj. Në kuptimin e përgjithshëm, shkollimi (apo siç dëshirojnë ta quajnë perëndimorët – Edukimi) ndahet në katër nivele: shkollimi i ultë, i mesëm, i lartë dhe shkollimi postdiplomik. Ndërsa institucionet që ofrojnë arsimin ndahen në Publike (shtetërore) dhe Private.

Deri para luftës në Kosovë, pra deri 1998, të vetmet institucione që ofronin "shkollim" privat ishin kurset e gjuhëve të huaja, dhe ndonjë ndërmarrje tjetër që ofronte certifikata për zanate të ndryshme. Arsyet për këtë gjendje janë të njohura. Pas luftës, mbijnë me dhjetëra shkolla fillore, të mesme e universitete, krejt këto të karakterit privat. Cilësia edukative, në këto shkolla, me përjashtim, ishte e pa kontrolluar nga asnjë autoritet shtetëror, dhe së fundi doli të ishte qesharak, për shumë sosh. 'Cirkusit' arsimor në Kosovë i vije fundi në vitin 2004 kur formohet Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK).


Misioni i kësaj agjencie, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë është: Hapja e sektorit të arsimit të lartë për ofertues vendor dhe të huaj; Sigurimi i cilësisë në sektorin e arsimit të lartë; Sigurimi, inkurajimi dhe zhvillimi i cilësisë në sektorin e arsimit të lartë; Krijimi i transparencës dhe kraha-

sueshmërisë në interes të ofertuesve, studentëve dhe tregut të punës; Inkurajimi i përmbajtjeve dhe formave inovative të arsimit të lartë; Sigurimi i krahasueshmërisë së diplomave të lëshuara nga bartësit e arsimit të lartë kosovar me diplomat ndërkombëtare; Aplikimi i qëllimeve të caktuara për integrim në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe zhvillimin e saj.

Shumë institucione të larta shkollore, nuk i përmbushin kriteret e AAK dhe nuk akreditohen. Të tjerat që plotësojnë kushtet vazhdojnë punën me krenari. Kjo agjenci monitoron nga afër secilin institucion të mesëm ose të lartë shkolror dhe për çdo vit akademik lëshon ose merr licenca akredituese nga shkollat në fjalë, varësisht nga performansa edukative dhe kushtet që Agjencia kërkon.

Përparësitë e shkollimit privat janë dukshëm më të mëdha sesa ato të shkollimit publik. Në kolegjet private ekziston një frymë e re studimi. Sistemi është pro-perëndimor dhe synon të jetë aplikativ. Planprogrami mësimor, infrastruktura shkollore, sistemi i provimeve, relacioni student-profesor etj. janë të gjitha risi në shoqërinë tonë. Mendoj se çdo kolegji privat në Kosovë, energjinë e vet punuese e drejton kah studenti me tendencën që ta përshtatë atë për tregun e vogël kosovar dhe tregun e madh evropian.

Përderisa metoda e krahasimit mbetet mënyra më e drejtë për të ditur më të mirin, atëherë po e tërheq një diagonale krahasuese në mes shkollimit të lartë privat dhe shkollimit të lartë publik në republikën e Kosovës. Si shembull konkret po marr ligjëratat e



Oxford

të lartë privat

profesorëve, që mbetet faktor kyç për studim, saktësisht orarin e ligjëratave. Në shkollat publike orarin e ligjëratave e cakton profesori i cili është bartës i lëndës së caktuar, në "koordinim" me udhëheqësin e fakultetit. Atje, kjo ligjëratë mbahet 1 herë në ditë, qofshin edhe 500 studentë. Te shkollat private, me karakter të shkollimit universitarë, kjo dukuri është shumë më fleksibile për studentët. Ligjëratën profesori e mbanë deri 3 herë brenda ditës. Dhe studenti e ka të drejtën ekskluzive, se kur ai/ajo dëshiron të vijoj ligjëratat – paradite, pasdite ose në mbrëmje. Sot, shumë të rinj punojnë, dhe orari i punës i limiton dukshëm në participim të ligjëratave. Nuk është i rrallë fakti që profesori të mungojë në ligjëratë, gjë që është e natyrshme, por në shkollat private njoftohen studentët pjesëmarrës paraprakisht me e-mail (është gjest për çdo lëvdatë që i takon UBT-së dhe Lirkës) dhe arsyen formale të mungesën. Karshi kësaj

dukurie, Universiteti i Prishtinës është me kilometra larg, në kuptimin negativ të faktit. Në UP, termi "provimi shtyhet për nja 1 javë!", është i njohur dhe irritues për studentët e këtij institucioni. Ndërsa 6 orë pritje paraprake, kohë kjo e çmueshme rinore, shkojnë në bisht të sorrës. Asnjë sqarim, asnjë arsye! Zyra për ankesa ekziston, mirëpo zyrtari kompetent nuk gjendet në zyrë. Ka dalë me arsyen abstrakte "Me'u taku me njanin për nifar pune".

Përparësi tjetër, në shkollimin e lartë është komunikimi (konsultimi) me profesorin përmes email-it. Në fakultetin tim Shkenca Kompjuterike në UBT, shumica e profesorëve qysh në orët e para të ligjëratave, i kanë bërë publik email-at e tyre për ne, që të ju shkruajmë për çdo çështje. Me këtë mënyrë të thjeshtë e me kosto minimale, evitohen radhët e gjata para zyrave të profesorëve të UP-së, të cilët nëse për fat kanë qelëuar në zyrë do të na pranojnë neve porsa t'i kryejnë disa punë të rëndësishme (të rëndësishme?). Kam përvojë për këto, prandaj po them! E mira e radhës e komunikimin me email është edhe evitimi i kontaktit direkt student-profesor. Dorën në zemër, disa studentë ende ia kanë frikën "Profës" apo autoritetit të tij.

Tjetra – në fakultetin tim nuk ka shanse teknike dhe teorike të dëgjohet në klasë zëri i muzikës që vjen nga "bufeja", me ç'rast "Filan Fisteku i uron Fistek Filanit shërim të shpejtë nga zorra çorre, urimit i bashkëngjiten ky, kjo, ajo, ata...urimin e përcjell e mirënjohura...". Kjo nuk ndodhë, dhe është bukur që s'ndodh!

"Mangësia" e vetme e shkollimit privat është kostoja e lartë që duhet të paguhet nga studenti. Është vështirë për ata si puna ime, që "ia kanë m'sy me i dal n'fun" me vetë-financim. Por asnjëherë nuk e vë në dyshim faktin që njeriu duhet të investojë në shkollimin e vet, për të ardhmen!

Sa për ilustrim, dhe për inkurajimin tuaj të vazhdoni ose të vijoni Shkollim Privat, po i përmend disa personalitete me famë botërore dhe shkollat përkatëse që ata kanë kryer:

Madeline Albright (ish sekretare shteti e SHBA)

Kent Denver School, Englewood, CO,

George H. W. Bush (babai)

Phillips Academy, Andover, MA

George W. Bush (i biri)

Phillips Academy, Andover, MA

Anderson Cooper (hulumtues CNN)

The Dalton School, New York, NY,

Jamie Lee Curtis (aktore)

Choate Rosemary Hall, Wallingford, CT

Benicio Del Toro (aktor)

Mercersburg Academy, Mercersburg, PA

Princess Diana (rest in peace)

Riddlesworth Hall, Diss, Norfolk, England,

Steve Forbes (pronar i magazinës Forbes)

The Brooks School, North Andover, MA

Jodie Foster (aktore)

Choate Rosemary Hall, Wallingford, CT

Mel Gibson (aktor)

St. Leo's College, Sydney, Australia

Howard Hughes (inovator)

The Thatcher School, Ojai, CA

Enrique Iglesias (këngëtar)

Gulliver Schools, Miami FL

John F. Kennedy (ish president i SHBA)

Choate Rosemary Hall, Wallingford, CT

Yo-Yo Ma (muzikant)

Trinity School, New York, NY

Bill Murray (aktor, Lost in translation)

Loyola Academy, Chicago, IL

Barack Obama (president aktual i SHBA)

Punahou School, Honolulu, Hawaii

Queen Noor of Jordan (mbretëresha e Jordanisë)

Concord Academy, Concord, MA

Gwyneth Paltrow (aktore)

The Spence School, New York, NY

Brooke Shields (aktore)

Dwight-Englewood School,

Englewood, NJ

Sonia Sotomayor (gjykatëse në

Gjykatën Supreme të SHBA (kjo vet e shkrun rrogën sa t'don)

Cardinal Spellman High School, New York, NY

Oliver Stone (regjisor dhe shkrimtar)


The Hill School, Pottstown, PA

Uma Thurman (aktore – Kill Bill)

Northfield Mt. Hermon School, Northfield, MA.

Donald Trump, Jr. (biznesmen dhe showman – i ka mbjellë flokët, por su bo rahat :))

The Hill School, Pottstown, PA



Mësimdhënësi i përkryer

Marrëdhënie të mira me nxënësët, respektimi i tyre, aftësi për të organizuar dhe menaxhuar klasën si dhe përgatitje korrekte për lëndën që e ligjëron. Kjo është receta e një mësimdhënësi të mirë, i cili arrin rezultate të larta gjatë punës me nxënësit.

FATBARDHA QEHAJA-OSMANI

Në dekadën e fundit, si asnjëherë më parë, janë nxitur debate dhe janë shprehur opinione rreth marrëdhënieve të mësimdhënësit me nxënësin dhe anasjelltas. Është e ditur se kjo çështje nuk është trajtuar në gjerësinë e duhur viteve të mëparshme sidomos tek ne në Kosovë. Thënë ndryshe, paraqitja e menjëherëshme e këtij fenomeni pas luftës së vitit 1999, pas një heshtjeje të gjatë është një paradoks i cili vlen të analizohet edhe nga aspekti sociologjik. Në këtë shkrim përfshihen qëndrime të avancuara për identifikimin e mësimdhënësve më adekuat. Po ashtu ky shkrim mbërthen në vete analiza të dala nga hulumtime shkencore në këtë lëmi.

Kush janë në të vërtetë mësimdhënësit e përkryer?

Në raportin e fundit të dalë nga Instituti danez për hulumtime edukative "DPU", Profesor Sven-Erik

Nordenbo, Drejtor i këtij instituti, shpreh mendimin se formula është shumë e thjeshtë. " Një mësimdhënësi të mirë i duhen tri kompetenca: kompetenca mbi zotërimin e lëndës, kompetenca mbi relacionin dhe kompetenca e menaxhimit. Dy kompetencat e fundit, megjithatë, përfaqësohen në mënyrë joadekuate në sistemin e edukimit bashkëkohor. Ky hulumtim vë në dukje rëndësinë e kompetencës mbi relacionin jo vetëm për mirëqenien e nxënësve por edhe për mësimnxënien e tyre të matshme në lëndën përkatëse. Kjo do të thotë se mësimdhënësit të cilët janë në gjendje të krijojnë relacione shoqërore, të respektueshme dhe pozitive me nxënësit arrijnë rezultate të shënueshme në punën e tyre.

Çfarë kuptojmë me thënien "kompetencë mbi relacione të mira"?

Aftësia për të krijuar lidhje individuale më nxënësit duke demonstruar një ngrohtësi, respekt, besueshmëri

dhe simpati nënkupton termin "kompetencë mbi relacione të mira". Mësimdhënësi është ai/ajo që duhet të shohë nxënësit në një fotografi më të madhe dhe të lexojë sinjalet e nxënësve, qoftë ato të mira apo jo të mira. Fatkeqësisht, disa mësimdhënësit janë aq të preokupuar me vetën e tyre sa që nuk arrijnë të vërejnë këto sinjale. Kompetenca e relacionit po ashtu implikon në vete mundësinë për tu ballafaquar me reagimet e nxënësve, madje edhe me reagimet më të papërshtatshme, dhe të jenë në gjendje t'i përgjigjen në formën më adekuate. Përparësia tjetër e kësaj kompetence është aftësia për tu ballafaquar me sfidën e rezistencës. Mësimdhënësit do të vihen në pozita kur do të duhet të ballafaqohen edhe me një grup tjetër nxënësish të cilët nuk janë të interesuar të kenë relacion të ngushte me mësimdhënësin, madje edhe në rastet kur ekziston edhe urrejtja për mësimdhënësin. Kjo do të thotë se të jesh i butë dhe i këndshëm nuk mjafton por duhet të jesh në gjendje të menaxhosh edhe njerëzit, konkretisht nxënësit.

Por kjo nuk është e tëra!

Sikurse çdo proces tjetër prodhimi, ekziston edhe elementi i menaxhimit të mësimdhënies. Gjërat duhet të planifikohen me kohë dhe të mirëmenaxhohen. Në profesionin e mësimdhënësit një kënd të veçantë e zë edhe logjistika apo përgatitja fizike e materialeve. Është me rëndësi që programi lëndës, "syllabusi", të ketë të qartë objektivat e mësimnxënies si dhe rezultatet e pritshme. Afatet kohore të përcaktuara nga ana e mësimdhënësit për seminare, konferenca, apo edhe detyra të thjeshta të nxënësve, duhet të respektohen. Të gjitha këto duhet të komunikohen me kohë në mënyrë të suksesshme tek nxënësit. Sa më i detajuar të jete plani i punës së mësimdhënësit, dhe



sa më mirë të menaxhohet klasa, aq më i madh është shansi që nxënësit të kenë rezultate në mësimnxënie. Menaxhim i klasës do të thotë të krijosh një varg rregullash të arsyeshme, të pa ngatërruara, dhe të qarta për klasën.

Mësimdhënësi me veprimet e tij krijon hartën e rrugëtimit të punës së tij dhe i shpjegon nxënësve se si të arrijnë progres kundrejt këtyre qëllimeve. Parimisht, përgjegjësia e progresit bie në përgjegjësinë e mësimdhënësit, mirëpo pjesë e kompetencës së menaxhimit është që gradualisht t'i përgatisë nxënësit që ata vet të marrin nën mbikëqyrje një pjesë të këtij plani.

Deri vonë është menduar se kompetenca mbi relacionin ashtu edhe ajo e menaxhimit janë vetëm aftësi individuale dhe dhunti të natyrës. Jo shumë vite më parë, në kohën kur unë kam qenë nxënës e ciklit të ulët dhe të mesëm kam dëgjuar të thuhet: "Mësuesi është i lindur, jo i krijuar".

Trendet e reja në edukim kanë arritur të modifikojnë këtë teori duke komplementuar atë me segmentin e krijimit, i cili arrihet përmes trajnimeve dhe avancimeve pedagogjike.

Si t'i shmangemi mësimdhënësve anti-social?

Për në fund shtrohet pyetja se a është e mundur që çdo mësimdhënës të jetë në gjendje apo madje edhe të mësojë se si të menaxhojë pakënaqësitë në klasë? Rekomandohet që kjo pyetje të jetë temë e një projekti hulumtues në të ardhmen.

Të gjithë e dimë se aftësitë e njeriut mund të zhvillohen përmes praktikës, mirëpo sipas institutit hulumtues "DPU" në rast se ndokush dëshmon të kundërtën, atëherë më të vërtetë do të duhej të bëhej një analizë më e gjerë se a mund çdokush të bëhet mësimdhënës.

Autorja është mësimdhënëse në UBT dhe udhëheqëse e Zyrës për Sigurimin e Cilësisë

Larg kaosit urbanistik, drejt arkitekturës evropiane

Mund të kalosh shumë rrugë e rrugica të kryeqytetit tonë, por mjerisht shumë pak do të shijosh arkitekturë të mirëfilltë.



Pristina - qendër metropolitane. Shpesh na pëlqen ta quajmë edhe kështu! Dëshirat njerëzore janë të mëdha por jo edhe të parealizueshme. Qytet kaotik. Shpesh herë i ngjanë një qyteti i cili nuk ka rregull, ka ngufatje, duket i mbytur në ngushtësinë e tij. Mbindërtimet pa leje -pa pëlqim urbanistik, shpeshherë edhe me leje, por të ndërtaura pa shije, pa hapësira gjelbëruese, pa vend-parkingje, e me një ambient tejet të ndotur. Nuk tregohet kulturë për ruajtje dhe mbrojtje të tij, e besa edhe i lënë në harresë edhe nga institucionet komunale e shtetërore. Rrallë herë arkitekturë, shpeshherë anti-arkitekturë! Rrënim i objekteve me vlera historike e arkitekturale, e ndërtimi i objekteve "moderne" që analizuar në tërësi, nuk përfillin dhe përmbushin as standardet elementare për ndërtim. Sheshet dhe hapësirat publike që do të duhej t'i kishte çdo kryeqytet evropian, i cili synon që të quhet edhe metropol janë larg syrit të çdo qytetari që jeton në Prishtinë. Arkitektura e mirëfilltë rrallë here bie ndesh me syrin e njeriut, mund të kalosh shumë rrugë e rrugica të kryeqytetit tonë, por mjerisht shumë pak do

të shijosh arkitekturë. Ashpërsia dhe vrazhdësia e punimeve gati asnjëherë nuk bien ndesh me formën dhe arkitekturën. Ndërtesa të ngërthyer në njëra tjetrën të lënë përshtypjen se ne mbarimin e një ndërtese, fillon ndërtesa tjetër. Tani kur vlugu i punës për ndërtim dhe rindërtim ka marrë përmasa shumë të mëdha askujt si shkon në mend se a është kjo më të vërtetë arkitekturë apo duhet të marrim shembull shtetet e zhvilluara. Por ne, si arkitektë të ardhshëm, do të punojmë për një kryeqytet larg kaosit urbanistik dhe drejt një arkitekture evropiane. "Arkitekturën" të cilën po e ndërtojmë sot në Kosovë nuk duhet të analizohet shumë se çfarë po ndodh me ndërtime, por thjesht duhet t'ju themi STOP ndërtimeve që janë larg standardeve dhe kodeve evropiane dhe ndërkombëtare. Dhe një herë e mirë të vetëdijesohemi e të punojmë në të mirën tonë dhe gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ardiana Qorraj & Egzontina Shabi - studente të vitit III-të të Arkitekturës në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT)

Bisedë me dr. Thomas Hrabal, dekan dhe ligjërues në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT

Arkitektura është më shumë se një dizajn i zbukuruar

Arkitektura në Kosovë duhet ta zhvillojë identitetin e vet dhe në anën tjetër duke qenë në kontakt me zhvillimet ndërkombëtare. Shpresoj që Fakulteti i Arkitekturës në UBT mund të bëhet një qendër për lidhjet e nevojshme ndërkombëtare. Prof. dr. Thomas Hrabal flet për UBT News.

NAILE DEMIRI

UBT News: Z. Hrabal si do ta vlerësonit punën e bërë në UBT, e veçanërisht në degën e arkitekturës?

Thomas Hrabal: Me të vërtetë dua ta vlerësoj vizionin e UBT-së dhe angazhimin e Dr. Hajrizit e stafit të tij. Unë jam krenar që jam në gjendje të deklaroj se brenda kësaj organizate ambicioze, departamenti ynë ka fituar një reputacion të shkëlqyer lidhur me profesionalizmin e tij të lartë dhe organizimit të mirë, që është një rezultat i bashkëpunimit të mirë të z. Beqaj dhe ekipit të tij lokal me mua dhe kolegët e mi ndërkombëtar.

UBT News: A mendoni që brenda një kohe të shkurtë nga UBT do të dalin arkitektë të shkëlqyeshëm, në veçanti ata studentë që janë trajnuar nga kadro të njohura, siç jeni edhe ju?

Thomas Hrabal: Përgjegjësia jonë është që t'i pajisim studentët tonë me arsimimin më të mirë dhe të bëjmë ushtrime praktike me ata brenda një periudhë të shkurtër kohore. E ardhmja do të tregojë se sa prej tyre do të kenë sukses në biznes, por unë do të thoja se pak nga ata, të cilët ndoshta nuk do të kenë sukses, nuk do ta kenë justifikim për atë dështim faktin që kanë studiuar në UBT.

UBT News: A jeni të kënaqur me kushtet që UBT i ofron në përgjithësi dhe degën e arkitekturës, në veçanti ?

Thomas Hrabal: Mendoj se ne nuk duhet kurrë të jemi të kënaqur, sepse duhet vazhdimisht të për-

piqemi që të përmirësojmë kushtet për studentët dhe kolegët tonë. Megjithatë, në përgjithësi UBT ofron kushte, të cilat përputhen me ato në Universitetet e Europës Perëndimore.

UBT News: Të flasim për arkitekturën në Kosovë. Si e vlerësoni arkitekturën e sotme në vendin tonë?

Thomas Hrabal: Arkitektura bashkëkohore në Kosovë është në të njëjtën periudhë të tranzicionit sikurse i gjithë shteti i ri. Ajo përballlet me sfida e probleme të mëdha dhe kjo shihet. Për fat të keq, lakmia e investitorëve për të ndërtuar me pak para ka bërë që shumë projekteve t'u mungojë qëndrueshmëria, si teknikisht ashtu edhe nga ana estetike.

UBT News: Çfarë do të ndryshonit Ju në Prishtinën e sotme?

Thomas Hrabal: Prishtina nuk ka histori e të qenit një kryeqytet. Prandaj planifikimi aktual urban duhet të reflektojë mbi atë çështje dhe në rritjen e shpejtë të qytetit. Qyteti ka nevojë për vende posaçërisht të projektuar dhe objekte për identitetin e tij të ri, të bëra në shkallë të duhur. Për më tepër, fokusimet për zgjerimin e Prishtinës duhet të përcaktohen sa më shpejt që është e mundur.

UBT News: A do të kishit mundur që Ju dhe studentët tuaj të UBT-së të kontribuonit në përmirësimin e kësaj gjendjeje?

Thomas Hrabal: Synimi jonë është që të kontribuojmë në ardhmërinë arkitektonike të Kosovës. Shpresoj se vendimmarrësit nuk i frikësohen transferit praktik të njohurive, por tregohen të gatshëm të



kuptojnë se arkitektura e sotme moderne mund të shtojë në masë të madhe vlerën në projektet e tyre si dhe në komunat e tyre.

UBT News: Duke pasur një përvojë të gjatë në mësimdhënie në vendin tuaj, mund të bëni një krahasim në mes të arsimit të lartë atje dhe arsimit të lartë në Kosovë?

Thomas Hrabal: Për një kohë të gjatë në Europën Perëndimore institucionet e arsimit janë shumë stabile, e cila mund të shihet si një përparësi dhe në të njëjtën kohë edhe si një mangësi. Në Kosovë jostabiliteti i kohës së fundit paraqet rrezikun e humbjes së një gjenereate por gjithashtu jep mundësin e rifillimit nga një institucion i lakmueshëm siç është UBT. Esenca gjithmonë është se çka njerëzit mund

të përfitojnë nga një situatë.

UBT News: Zotëri profesor duke pasur parasysh se te ne mesatarisht në çdo gjysmë shekulli ka pas luftëra dhe shkatërrime, sa kemi të drejt që disa objekte fetare, shtëpi banimi, mullinj e në veçanti kulla, po futen në mbrojtje të shtetit si begati të trashëgimisë kulturore?

Thomas Hrabal: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore duhet të jetë e rëndësishme, pavarësisht nga situata.

UBT News: Po arkitektura e sotme në Kosovë sa i përcjell trendet e zhvillimit të arkitekturës në shtetet perëndimore?

Thomas Hrabal: Nuk duhet t'i ndjekim trendet e huaja. Arkitektura në Kosovë duhet ta zhvillojë identitetin e vet dhe në anën tjetër duke qenë në kontakt me zhvillimet ndërkombëtare. Shpresoj që Fakulteti i Arkitekturës në UBT mund të bëhet një qendër për lidhjet e nevojshme ndërkombëtare.

UBT News: Dhe së fundi, çfarë do t'i porositnit Ju studentët tuaj, por edhe institucionet përgjegjëse lidhur me arkitekturën që sot po zhvillohet në Kosovë, është e qëlluar apo duhet ndryshuar?

Thomas Hrabal : Në përgjithësi do t'iu thoja që:

- Të veprojnë në mënyrë të qëndrueshme. Mos shikoni në përfitimë të shpejta dhe famë, por punoni shumë, në mënyrë që të ofroni zgjedhje të mirë klientëve dhe komunitetit tuaj.

- Jeni të vetëdijshëm se arkitektura e mirë është më shumë se sa një dizajn i zbuluar, por gjithashtu duhet të jetë një përgjigje e mirë të shumë parametrevave si p.sh. nevojave të funksionalitetit.

- Mos shikoni prapa, por koncentroni energjinë tuaj për të marrë përgjegjësi për projektet për të ardhmen e vendit tuaj.

- Mendoni në mënyrë sistematike dhe jeni të vetëdijshëm për sfidat e ndryshme që i takojnë arkitekturës.

Environment of Students in Kosovo

YLBERINA GASHI

Kosovo it's known with its youth population, most of them are dedicated for their education and better future. Being a student means you need to handle a lot of difficulties that you face everyday. This describes that you're getting mature and more independent person which bears you with more responsibility in every aspects. After finishing high school there is a time when you should decide about your future, and the field that you're interested to study. The main difficulties for people who live in rural places is that they have to commute to Prishtina to finish their studies. Regarding their accommodation a student can decide either to commute every day or to locate in convicts that they are especially build for foreign students, in the end those who have better economic conditions they can chose private houses to live during their studies.

There are several options for studying in Prishtina. Starting with Public University which has a lot of directions and huge number of students and continuing with Private Universities which are more preferred from those who are willing to study in different way. Even though public Universities are almost free and administered by the government there is still high number of people willing to attend private Universities with the aim of being educated, where the level of learning is more up-to-date. The difference between Private and Public Universities is that in Private Universities you have more space to express yourself and to learn in the mean time, while in Public Universities the high number of students does not leave space for student's ideas. But, deciding which way you want to follow between Public and Private Universities you need to manage your finance, too. This is because Private Universities with better conditions of studying are much more costly. Beside, if you decide to live in capital city, you need to think if you can handle the expensive life here. On the other hand, a good opportunity for students can be to work and to keep going on with the studies in the mean time.

This is the reason why most of young people get disappointed with this method, because you either need to dispose a good economic situation to study properly, or you have to handle all the difficulties in Public University. That's why most of young people are very eager to challenge themselves in foreign countries and see the possibilities of earning a scholarship and leave



the old system in Kosovo behind. Leaving a country is not so easy because firstly you need to visit an embassy and get a permission or so called Visa to leave the country and go somewhere else to

study. During studies students find enough time to get involved in free activities too. Prishtina is known with several opportunities that you might enjoy. You might choose the opportunity to play bowling with friends or go and play tennis as well. There is also a place that you can enjoy horsing. An important point to mention is that students take care about their wealth as well., they either decide to go running in nature or they visit fitness centers when the weather get cold. During the winter we have some gorgeous places for skiing and resting, this is mostly during the winter holidays when we have more free time to use.

Our University also allows all students to get involved with the activities that are inside the University. They can be a part of exhibition or help in other area that is needed to be contributed from us. We as a student also enjoy night life. There are several places that you might visit and enjoy with your company. It depends from the personality, if you are more quite and shy person you have some bars and lovely places to visit, or you might be more energetic and outgoing person still you may visit pubs that fits with your nature.

In the end we are still confident that our generation will do something to contribute in the future events to make the living and studying much more easily for all young people.

90 Vjetori i Bauhaus

Trashëgimia e modernizmit

Lëvizja legjendare Bauhaus kremton 90 vjetorin, duke u shënuar me ekspozita nga Tokio në Nju Jork. Shkolla u themelua nga një arkitekt i ri, Walter Gropius, i cili donte të formësonte produktet për të ardhmen dhe të krijojë një shoqëri më të drejtë.



BERSANT SELMANI
Arkitekt
(Bauhaus DIA, Germany)

Në kohët e errësirës dhe dënimit, ka shpesh një nevojë për energji karizmatike të ideve të mëdha. Më 1919 arkitekti gjerman Walter Gropius konsideronte periudhën e mjerueshme pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore si një katastrofë "e historisë botërore." Përgjigja e tij ishte një vizion utopik i guximshëm dhe pragmatik - Bauhaus. Duke krijuar këtë lloj të ri të shkollës së artit dhe arkitekturës, ai arriti të krijojë një çudi kulturore që vazhdon të ketë një ndikim të madh deri sot.

Ky vit shënon 90 vjetorin e themelimit të shkollës: Një seri e ngjarjeve dhe ekspozitave janë gati për të na kujtuar se, pa Gropius, bota e arkitekturës dhe projektimit do të dukeshin më të ndryshme sot.

Gropius, i cili ishte 35 vjeç në atë kohë, ishte i vendosur të kthehet kundër traditës dhe akoma, në një mënyrë tërësisht modës së vjetër, ai kërkoi gjithashtu të marrë përgjegjësinë sociale. Më 20 mars 1919, ai paraqiti një kërkesë për të ngritur një akademi në qytetin e Weimarit. Leja për "Bauhaus Kombëtar në Weimar" arriti më 12 prill. Në ndërkohë, arkitekti shkruan një manifest gjithëpërfshirës. Kjo ishte për të shënuar fillimin e një përmbysje të vërtetë estetike në gjithë botën - me pak fjalë, një revolucion i vërtetë.

Prej fillimit Bauhaus ka dëshmuar të jetë një shkollë interesante e artit dhe arkitekturës, një akademi që kishte qëllim që të jetë më e afërt me jetën reale dhe jo një institucion i lartë akademik. Bordi i besuar, i cili përbëhej nga rrethi i miqve të Gropius,

përfshinte Albert Einstein, dhe në mesin e profesorëve llogariten disa prej piktorëve kryesorë të kohës si Josef Albers, Lyonel Feininger, Wassily Kandinsky, Paul Klee dhe Oskar Schlemmer. Ludwig Mies van der Rohe, i cili ishte drejtor i tretë i Bauhaus, vazhdoi të bëhet një legjendë në historinë e arkitekturës.

Këtë vit 90 vjetori i themelimit të Bauhaus do të festohet me ekspozita në Weimar dhe Berlin, Tokio dhe Nju Jork, dhe me botimin e një numri rekord i librave të reja. Edhe Muzeu Nju Jork i Artit Modern (MoMA) ka planifikuar për të festuar 90 vjetorin e Bauhaus. Alfred Barr, drejtori i parë i MoMA, u frymëzua kështu nga Bauhaus që arti evropian i kohës të bëhet qendër e muzeut të tij.

Dhe me arsye të mirë: Në fund të fundit, ajo ishte shkolla që krijoj imazhin e kohës moderne. Për Bauhaus kjo ishte detyra e artistit që të braktisë zakonet e vjetra. "Akti i parë i Bauhaus ishte ti shemb të gjitha mendimet e vendosura ... Pa pritmas njerëzit zbuluan se jeta mund të shikohet nga një perspektivë krejtësisht e ndryshme," shkruan Lisbeth Oestreicher, një i diplomuar i Bauhaus.

Kjo trashëgimi moderniste është e pamohueshme. Deri në ditët e sodit, Bauhaus shërben si një lloj i reperit për ata që i përkasin avant-gardës në art, dizajn, arkitekturë dhe planifikim urban. Për më tepër, ajo formon bazën për reputacionin modern të Gjermanisë dhe vetë-imazhin si një vend i përparimit artistik.

Kërkesa për Trashëgiminë e Bauhaus

Gjatë një periudhe 14 vjeçare, Weimar, Dessau dhe Berlin ishin tri baza të shkollës. Pastaj, në vitin 1933 shkolla ishte mbyllur më në fund nga kundërshtarët e kulturës moderniste.

Sot, në një homazh të vonuar për Bauhaus, Weimar dhe Dessau janë caktuar nga UNESCO vende të trashëgimisë kulturore botërore.

Bauhaus ka mbijetuar si një legjendë, u mbajt gjallë nga puna e mësuesve dhe studentëve të cilët u larguan pas 1933. Një lëvizje e pavarur moderniste Bauhaus u zhvillua në Izrael. Një Bauhaus i ri u hap në Çikago në vitin 1930, dhe Nju Jork do të ishte sot një qytet krejt ndryshe pa estetikën e importuar nga Gjermania të çelikut dhe xhamit. Përfundimisht, purizmi i Bauhaus u bë shumë dogmatik për lëvizjen post-moderne të viteve 1980, kur arkitektët kërkuan të ngrinin krye kundër një legjendë që ishte bërë më e madhe se vet jeta.

Në Gjermaninë e ndarë të pasluftës, si Lindja dhe Perëndimi pretendojnë për trashëgiminë e Bauhaus. Më vonë kanë qenë kritikët, të cilët argumen-



tuan se blloqet e apartamenteve dhe godinat e shëmtuar të parafabrikuara të banimit qenë një rezultat i drejtpërdrejtë i vizionit të Bauhaus. Por këto përpjekje për të ç'mitizuar Bauhaus, kurrë nuk patën sukses.

Në 2009, në përvjetorin e Bauhaus, ndjehet se të gjithë e lavdërojnë Bauhaus, duke kremtuar shkollën si një laborator i dizajnit. Ajo është duke u shpallur një studio e madhe dhe e dashur, e cila pothuajse rastësisht zëri një risi të re të projektimit, duke sjellë estetikë në jetën e zakonshme. Por në realitet ajo ishte shumë më komplekse dhe kontradiktore, dhe mbi të gjitha më e rëndësishme se sa reputacioni i saj.

Akti heroik i arritur nga Gropius dhe miqve të tij ishte njohja dhe ekspozimi i fuqisë socio politike dhe morale të arkitekturës dhe projektimit. Ata donin të ushtronin "ndikim efektiv" mbi "kushtet e përgjithshme," të një bote më të drejtë dhe ti kthejnë të gjithë në një "shqetësim vital për gjithë popullin."

Nocioni i arkitekturës se është politike - sepse ajo dizajnon konkretisht kushtet e jetesës dhe si e tillë mund të shkaktojë polemika dhe kundërshtim - është një nocion që dërgon përsëri në Bauhaus.

Natyrisht, kjo dëshirë për ta bërë

botën një vend më të mirë sot konsiderohet shpesh si një e metë. Por ndoshta kjo është koha për të shkuar mbrapa në këtë frymë origjinale. Institucionet pasardhëse të shkollës - Fondacioni Bauhaus, Dessau Instituti i Arkitekturës dhe Universiteti Bauhaus i Weimar - mund të vendosin që të rikthehet qasja revolucionare e Bauhaus.

Krijimi i një Elite

Më 1919, vështirë se dikush mund të ketë parashikuar se Bauhaus do të bëhet objekt i një magjepsje të përjetshme. Në fund të Luftës së Parë Botërore, bota e artit gjerman ishte ngrirë në një gjendje të traumës. Ata që kishin shpëtuar gjallë nga llogoret, luftonin të mbijetojnë financiarisht, dhe e ardhmja dukej politikisht dhe ekonomikisht e pasigurt.

Pastaj Bauhaus kishte ardhur si një dritëz shprese. Gropius konsideronte se koncepti i paraluftës për artistin si një bohem të ishte naive. Ai u përpoq të krijoi një fondacion që mund të mbështeste piktorët, dizajnerët dhe arkitektët. Në vizionin e tij, zanati do të jetë bazë e të gjitha përpjekjeve artistike, dhe në shkollë ai krijoi punëtorin për mjeshtër profesorë dhe studentë praktikantë.

Qëllimi i tij ishte për të sjellë së bashku intelektin, talentin dhe energjinë. Të gjitha produktet që u krijuan në Bauhaus – çdo karrige, llambë, dorezë ose mural - duket se përmbajnë këtë bërthamë të besimit. Karizma që Bauhaus vazhdon të ushtrojë sot erdhi nga ky besim dhe nga fakti se shkolla tërhoqi të rinj shumë ambicioz.

Shumica e studentëve të Gropius ishin të varfër dhe të uritur - figurativisht. Ata ishin të uritur për jetën dhe diturinë, për eksperimente estetike dhe kënaqësi fizike. Atyre ju mungonte çdo gjë, që nga materialet e punës deri te veshmbathja dhe banesa. Restoranti i shkollës, u hap në tetor 1919, u zhvillua në një nga vendet më të rëndësishme në ndërtesë dhe akademia mbillte kopshite të saja. Pavarësisht nga këto rrethana modeste, nxënësit dhe mësuesit zhvilluan një vetë-besim të madh, ndjenjë e të qenit pjesë e një grupi elite, ose të paktën një grup

njerëzish që kanë qenë përjashtim nga rregulli.

Rizgjimi i Besimit në Makinë

"Ne kemi jetuar së bashku si vëllezër", thotë Bauhaus student i Re Soupault. Kushdo që erdhi për të studiuar në shkollë kishte refuzuar tashmë prejardhjen e tyre borgjeze. Soupault, për shembull, pranon ndarjen me familjen e tij si një e "keqe" e domosdoshme.

Kjo bëri që të mos përputhet me popullatën lokale. Për drojën e qytetarëve të Weimarit, "njerëzit e të dy gjinive Bauhaus" rreziteshin jashtë të zhveshur, dhe marrëdhëniet "e tyre të shturura" kishin prodhuar edhe fëmijë.

Bauhaus u bë një komunitet që ka dhënë konventa plotësisht të reja për të rinjtë. Vitet e para ishin mjaft ezoterikë, me piktorin zviceran Johannes Itten duke vepruar si një lloj guru. Një ndjekës i mësimëve të Lindjes së Largët duke mbajtur kokën e tij të rruar dhe duke u veshur si murg, Itten kërkonte nga studentët e tij për të hequr "të gjitha konventat."

Në fillim Gropius kishte tentuar të fuste shpirtin në epokën e industrializuar, me besimin e tij në rëndësinë e zanateve dhe preferencat e tij për drurin si material, të cilat janë përdorur nga ndërtuesit e Mesjetës. Megjithatë, drejtori shpejt kishte hequr këto nocione fillestare dhe idealizim të tij për të kaluarën. Ai dënoi artin e pastër si një qëllim në vetvete, dhe vazhdoi të refuzoi për të prodhuar "artikuj luksu." Por ai gjithashtu filloi të propagandoi me forcë arkitekturën dhe dizajnin e përshtatur për mundësitë e industrisë.

Në 1923, ai shpalli moton: "Arti dhe Teknologjia - Një njësi e re." Drejtori i Bauhaus kërkonte shpejtësi, duke dashur për të kapërcyer "ngadalësinë tokësore." Ai u ankua se disa anëtarë të Bauhaus preferonin "një kthim tek natyra, duke preferuar të gjuajnë me hark në vend të armës së gjahut."

Besimi në fuqinë e vjetër të makinës nga ditët e paraluftës ishte rizgjuar. Dhe kjo shkaktoi një debat të ndezur mbi drejtim që Bauhaus duhet të marr. Një nga skeptikët u Bauhaus, profesori Georg Muche, refuzoi të



hynte në një marrëdhënie "të komprometuar" me "formën, të lirë nga kuptimi" me botën e jashtme. Kandinsky, gjeniu rus i cili kishte ndihmuar për të zbuluar artin abstrakt, ishte i shqetësuar gjithashtu nga fakti se "makina" ishte bërë "idhull."

Forma dhe funksioni, prodhimi dhe marketingu: gjithçka ishte rizbuluar. "I ri" ishte moto e kohës: Ndërtim i ri, vizion i ri dhe Njeri i ri.

Koncepti i "stilit" ishte gjithashtu kontrovers brenda institucionit, por ai ka ekzistuar, natyrisht, si stili Bauhaus. I liruar nga të gjitha ornamentet, ky fjalor minimalist i formës ishte një shfaqje inteligjente dhe demokratike. Që atëherë, mitologjia e modernizmit ka përfshirë çatinë e rrafshët, logjikën funksionale të një karrige dhe çështjes së dizajnit të një ibrik çaji metalik.

Tensionet në Weimar Nacionalist

Konservatorët Weimarit e nihatën përmbysjen e komunizmit. Në një deklaratë zyrtare, ata dënuan "eksperimentimin brenda se njëanshmes, të shijes moderne" dhe "politikën e lëvizjes më radikale." Ushtria e perandorit gjerman ishte vendosur në kërkim të shtëpisë së Gropius, dhe situata u bë gjithnjë e më e tensionuar. Nga marsi 1925 ndryshuan gjërat dhe të gjithë profesorët e Bauhaus u larguan. Ishte e qartë se qyteti i Weimarit, ku mjedisi politik ishte bërë gjithnjë e më shumë nacionalist, konservativ dhe reaksionar, nuk kërkonte asgjë më nga shkolla e Bauhaus.

Bauhaus, megjithatë, nuk do të mbyllet lehtë. Akademia u rilind në qytetin e Dessau dhe këtë herë me ndërtesën e saj moderne të shkollës me një konvikt të studentëve dhe vila për profesorët, të gjitha të projektuara nga Gropius. Tani Bauhaus ishte një universitet i vërtetë.

Më në fund shkolla - dhe, mbi të gjitha, Gropius - mund të shprehte arkitekturën në një mënyrë të veçantë: Qyteti porositi shkollën për të ndërtuar një lagje të tërë banimi. Qyteti Industrial i Dessau duket të jetë anije e përkryer për energjinë me shpejtësi të madhe të Bauhaus.

Por grupi nuk ishte ende i unifikuar plotësisht. Ise Gropius, gruaja e drejtorit, nuk pajtohej me piktorët e shkollës, që ajo i konsideronte shumë



të ndryshëm, dhe shkroi në ditarin e saj: "Njerëzit si Klee dhe Kandinsky janë të pavëmendshëm në situata të vështira, ata nuk e lexojnë gazetën dhe ata mbyllen në vetvete në studiot e tyre."

Mësuesit jetonin me stil në vilat e bardha, që Gropius kishte projektuar, por kjo e bezdiste Kandinsky, që të gjithë mund të shohin në shtëpinë e tij përmes dritareve të mëdha. Oskar Schlemmer, piktor, kishte shqetësime të ndryshme. Ai kishte frikë se të pas-trehët do të shfaqen një ditë "derisa artistët janë duke u rrezitur në kulmet e rrafshëta të vilave të tyre."

Kur Gropius u largua nga shkolla në vitin 1928 për të ndjekur projektet e tij arkitektonike në shtetet e bashkuara, fillon një periudhë e politizimit të gjerë. Drejtori i ri, Hannes Meyer, simpatizonte Partinë Komuniste gjermane, por nuk ishte anëtar i saj. Shumë vëzhgues më vonë erdhën në përfundim se ka qenë shumë radikal. Sipas tyre Meyer, një avokat i "nevojave të popullit," nuk u përshtat me klimën intelektuale të Bauhaus.

Persekutimi dhe Emigrimi

Për Meyer, "mungesa kolektive" që e kapi menjëherë pas fillimit të krizës ekonomike botërore ishte një sfidë personale. Në të njëjtën kohë, ai kishte vërejtur se Bauhaus kërcënohej për t'u bërë shkollë e modës. "Një revistë e modës në Vjenë rekomandon që të brendshmet e femrave të jenë më pak të dizajnuara me lule, por me dizajn geometrik në stilin bashkëkohor

Bauhaus", ka shkruar redaktori i revistës së shkollës.

E megjithatë ishte nën patronazhin Meyer kur një produkt ndoshta më i vogël - dhe më i suksesshëm - u zhvillua për kompaninë prodhuese të shkollës: një qilim Bauhaus, me modelet delikate me vija, me rrjeta dhe sipërfaqe, të gjitha në ngjyra të ndryshme.

Mbeti pak prej qëllimeve fillestare të krijimit të një estetike të re për një botë të re, më të drejtë. Shumë nga objektet e projektuar në Bauhaus ishin shumë të shtrenjtë shumicën, përveç klasës së lartë. Do të duhej marrë me prodhimin në masë për të bërë dizajnin të përballeshme për të gjithë.

Kur Meyer u zëvendësua nga arkitekti Mies van der Rohe në vitin 1930, fenomeni Bauhaus ishte tashmë në rrugën e përfundimit. Drejtori i ri ishte estetik, një mjeshtër i elegancës dhe përsosmërisë, por ai nuk ishte as politik e as një reformator shoqëror. Ditët e shkollës po përfundonin.

Partia naziste kishte fituar tashmë forcë në shtetin e Saksony-Anhalt, ku Dessau gjendej, dhe në gusht 1932 këshilli i qytetit vendosi që të mbyllë shkollën. Edhe pse ajo u zhvendos në Berlin, një vit më vonë Bauhaus mbyllet.

Identiteti i Bauhaus bazohej në mosnënshtrim e saj. Megjithatë, në fund të fundit, një mësues dhe disa ish-studentë kanë kërkuar të jenë në përputhje me regjimin e ri nazist, i cili ishte i hapur për modernizmin teknik. Shumë të tjerë, megjithatë, u shpërngulën dhe ruajtën në këtë mënyrë reputacionin e këtij institucioni unik.

Gropius, i cili u bë profesor në Shtetet e Bashkuara, ndihmoi në formimin e arkitekturës internacionale. Në 1937, ai shkruan: "Një grup i tërë nga Bauhaus ka ardhur së bashku në këtë vend. Ky vend të jep ndjenjën që ka rrënjë të themeluara, diçka që secili prej nesh që është çrrënjësor, ka nevojë."

Në fund, nga të gjitha lëvizjet konkurruese avant-gardes të 1920, Bauhaus doli fitimtar.

Liberalizimi i vizave - Sfidë e madhe për Kosovën

LUM GJIKOLLI
viti I, MBE në UBT

Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është tema kryesore e të rinjve në vendin tonë. Ai proces është një sfidë e madhe në të cilën duhet të kontribuojnë shumë palë. Para se të hyjmë të shtjellojmë liberalizimin e vizave do të shtjellojmë historinë e tij dhe të shohim se çka do t'i mundësonte liberalizimi i vizave shtetit tonë. Më 26 prill 1999, këshilli i çështjeve të përgjithshme në konkluzionet e tij rekomandoi iniciimin e një procesi të ri, të stabilizim asociimit. Një element i këtij procesi do të ishte një kategori e re marrëveshjeve, e përshtatshme për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe RF të Jugosllavisë. Ky tip i marrëveshjes u quajt marrëveshja e stabilizim asociimit. Komisioni European u ngarkua të përpunonte këtë tip të ri marrëveshjeje kontraktuale dhe t'i paraqiste një raport Këshillit dhe Parlamentit European, gjë që e bëri më 26 maj 1999. Procesi i stabilizim asociimit u ofronte vendeve që do të përfshiheshin në të, stimuj më të lartë se më parë, por edhe më shumë kushte politike dhe ekonomike, duke nënvizuar veçanërisht nevojën e bashkëpunimit rajonal. Përmbytja e këtij procesi ishte një kombinim i zhvillimit të instrumenteve ekzistuese dhe të nismave të reja, që synonin një përmirësim të situatës. Zhvillimi i Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit si një lloj i ri marrëdhënieve kontraktuale, kishte në konsideratë situatë individuale të çdo vendi, në perspektivën e anëtarësimit në BE mbi bazën e Traktatit të Amsterdimit



dhe plotësimit të kriterëve të pranimi të Kopenhagës të vitit 1993. Objektivat kryesore të këtyre marrëveshjeve do të ishin: të afronin rajonin sa më afër perspektivave për integrim e plotë në strukturat e BE; të mbështesnin konsolidimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe reformat, të ndihmonin për struktura administrative të përshtatshme dhe për bashkëpunim rajonal; të krijonin një kuadër zyrtar për dialogun politik, në nivel të dyanshëm dhe rajonal; të nxisnin marrëdhëniet ekonomike, tregtinë, investimet, politikën e sipërmarrjes, transportin, zhvillimin dhe bashkëpunimin në zonat doganore në perspektivën e integritetit të afërt në sistemin tregtar botëror, përfshirë mundësinë e krijimit të zonave të lira tregtare, kur të arrihej një progres i mjaftueshëm në reformën ekonomike; të siguronin një bazë për bashkëpunim në fushën e drejtësisë e të rendit publik; të krijonin një bazë për bashkëpunim ekonomik, social, qytetar, arsimit, shkencor, teknologjik, energjetik, ambiential dhe kulturor (përfshirë një plan për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të këtyre rajoneve), të mbështetur përmes programeve të ndihmës, të orientuar nga asociimi, të cilat, gjithashtu, do të përcaktoheshin për të lehtësuar përafrimin e legjislacionit në përputhje me ACQUIS COMMUNAUTAIRE. Instrumentet në të cilat Kosova

dita e ditës po dështon janë shteti ligjor, administratë jo e politizuar publike, zhvillim të dobët ekonomik, papunësi e lartë. Më 10 qershor, në takimin e G-8, në Koln, u miratua pakti i stabilitetit për EJT. Po aty, të thirrur për të miratuar paktin, ishin të ftuar ministrat e punëve të jashtme të vendeve të Europës juglindore. Pakti i stabilitetit përfshiu një numër të madh vendesh dhe organizatash ndërkombëtare dhe katër nisma rajonale. Jugosllavia nuk u pranua në Konferencën e Koln-it. Pjesëmarrja e saj u kushtëzua me zgjidhjen e krizës së Kosovës dhe me demokratizimin e saj. Mali i zi u pranua në procesin e Paktit të Stabilitetit për shkak të zhvillimeve demokratike dhe si një nxitje për ndryshime në Beograd. Vendet pjesëmarrëse të Paktit u ndanë në dy grupe: në pjesëmarrës dhe përfitues si edhe në pjesëmarrës dhe përfitues si edhe një pjesëmarrës, ndihmues dhe lehtësues. Komisioni European numëron disa sfida që qëndrojnë para vendeve të pSA; ndërtimi i shteteve efektive demokratike, dobësitë në zbatimin e shtetit të së drejtës dhe në kapacitetet administrative, standardet e diskutueshme të sjelljes politike, (konfrontime serioze, skajshmëria, krizat, si norma të jetës politike) format ekstreme të nacionalizimit, shoqëri civile dhe media të dobëta, varfëria dhe privimi social, zgjerimi i bashkëpunimit rajonal. Suksesin afatgjatë të procesit të Stabilizimit dhe Asociimit në vendet e Ballkanit Perëndimor Komisioni e shikon në angazhimin e vazhdueshëm dhe një nxitje të re nga vendet e rajonit dhe të BE.

Prishtina tjetër e së nesërme

SHPEND FEJZULLAHU

Trendet e zhvillimeve europiane, Kosovën e gjejnë të vonuar, sado që tashmë është shtet me të gjitha karakteristikat. Ndërkaq, Prishtina, kryeqendër e Kosovës, një shtet i ri pra, do të duhej me të shpejt të bëjë përpamje e ndryshime dhe do të marrë pamjen e një kryeqendre moderne, e karakterizuar me imazhe të tjera, më atraktive.

Ndryshimet në infrastrukturë moderne, modernizimi dhe ndërtimi i ndërtesave dhe lagjeve të reja, me një arkitekturë të re, ngritja e parqeve dhe fushave me gjelbërim që do të përmirësojë ambientin për qytetarët, tashmë



janë imperativ, nëse duam të ecim përpara, kah Europa. Përmirësimi i rrugëve qarkore, duke mundësuar një qarkullim urban të transportit të lirshëm si dhe mirëmbajtja dhe modernizimi i qendrës së Prishtinës, do ta bënte Prishtinën një kryeqendër të modelit european. Ajo do të ishte pastaj mburrje për të gjithë qytetarët e Kosovës, e posaçërisht ata të kryeqendrës. Meqë Prishtina

është një kryeqendër universitare e bënë atë më vitale, më të gjallë, plot jetë rinore. Do t'ia kishin lakmi qytetet e tjera për këtë rini. Nëse këtij projekti të kryeqendrës i shtojmë edhe ndryshimet në periferi të qytetit duke marrë parkun e Gërmisë me pishinën e bukur, ndërtimin e qytetit të ri nga pjesa e Hajvalisë, vazhdimi i ndërtimit të magjistrales që lidh Prishtinën me Shkupin si dhe ngritja e zonës industriale në drejtim të Fushë Kosovës dhe aeroportit të Prishtinës, do ta shndërrojë kryeqytetin me të vërtetë në një qendër të bukur që do t'ia kenë lakmi të gjithë qytetarët e Kosovës.

Kjo do të jetë Prishtina e nesërme - kryeqendra e Republikës së Kosovës.

Fotografia është pasion

“Fakulteti i Shkencave Kompjuterike është drejtim me perspektiva multidimensionale, fakultet ndër më të fortit në Kosovë që e ofron Universiteti për Biznes dhe Teknologji”, thotë Agron R. Berisha, student në vitin e parë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në UBT.

UBT News: Prej nga pasioni për fotografimin?


Agron R. Berisha: Pasionin tim për fotografi e ka vërejtur rrethi i ngushtë familjar, kur unë isha rreth 14 vjeç. Në atë kohë pjesa më e madhe e teknologjisë ishte e formës manuale dhe analoge, prandaj edhe aparatet fotografues ishin me film, gjë që kishte çmim të lartë dhe merete shumë kohë. Më kujtohet shumë mirë, që si i vogël kam qenë adhurues i madh i kamerave, foto-kamerave dhe në përgjithësi i teknologjisë të asaj kohe. Me kalimin e kohës dhe zhvillimit teknologjik, pasioni ndaj fotografisë më shtoj dhe fillova të mendoj ta praktikoj këtë pasion të cilin e dua me të gjithë zemër.

Përderisa interesat lidhin njerëzit, atëherë unë fillova të shoqërohem me njerëz që për profesion e kishin fotografimin, por edhe me të tillë që fotografimin e shihnin vetëm si art, ashtu siç e shoh edhe unë. Kjo më shtyri deri te një vendim i rëndësishëm për kohën, e ndoshta edhe vendim i rëndësishëm jetësor – që të kursej mjetet për të blerë foto-aparatit e parë profesional (Single Lens Reflex – SLR camera).

UBT News: A të ndihmon në fotografi fakti që studion shkencat kompjuterike pasi për shembull editimi i fotografive për ty do të jetë me i lehtë me programet e ndryshme aplikative?

Agron R. Berisha: Thënë të drejtën jo. Por drejtimi im Shkenca Kompjuterike, besoj se do të më ndihmojë që ta kuptoj bazën e teknologjisë informative, që siç thashë më lart më pëlqen tej mase. Ky drejtim perspektiv po ashtu do të më ndihmojë shumë për punën që unë e bëj çdo ditë.

Duke ju referuar pyetjes tuaj, dua të them edhe diçka në lidhje me programet kompjuterike të dedikuara për editim të fotografisë. Kjo për



shkakun që lexuesit e kësaj gazete të jenë më të informuar: Programet e ndryshme kompjuterike, që zhvillohen ekskluzivisht për fotografimin, janë programe të cilat pak njerëz i kanë mësuar në shkollë ose kurse të ndryshme. Unë personalisht nuk e favorizoj një fotografi e cila është modifikuar substancialisht. Fotografia e ka bukurinë e vet, të momentit, e cila përcjell emocion tek shikuesi. I arsyetoj fotografët që punojnë me marketing ose fashion, por prapë se prapë fotografia e ka bukurinë e vet të çastit. Megjithatë, talentet më të mëdhenj të Photoshop-it, ose editorëve të tjerë të fotografisë, janë njerëz që të gjitha meritat i kanë vet ata. Thënë ndryshe në zhargonin akademik, këta janë njerëz autodidakt.

Po ashtu unë nuk besoj se Photoshop-in do ta kem lëndë gjatë shkollimit tim në UBT (hahaha).

UBT News : Cili profesion të fle më shumë fotografia apo shkencat kompjuterike, meqë njëri profesion kryesisht ushtrohet ulur në karrige pranë PC, e tjetri duhet

vrapiu pas ngjarjeve për të zënë momentin ideal për foto?

Agron R. Berisha: Sikur të isha foto-reporter pyetjes tuaj do iu përgjigjesha me opsionin e parë, pra Shkencat Kompjuterike. Por, përderisa bëj dhe më pëlqejnë fotografitë artistike atëherë nuk kam obligime dhe ndërhyrje nga jashtë. Përderisa është ndjesi emotive, atëherë të gjitha ndërmarrjet dhe “vrapimet pas ngjarjeve për të zënë momentin ideal” i bëj me plotë dëshirë dhe kënaqësi. Shkencat Kompjuterike, që unë e kam zgjedhur si subjekt për të studiuar në UBT është drejtim me perspektiva multidimensionale, dhe po ju them me bindje se ky fakultet që UBT e ofron është ndër më të fortit në Kosovë! (Nuk po them më i miri për hatër të modestisë).

UBT News: Çfarë fotografon më së shumti?

Agron R. Berisha: Fotografia ndahet në shumë kategori: Fotografi artistike, Fotografi abstrakte, Natyrë, Kafshë, Fotografi dokumentare, Nudo, Portrete, Makro, Astro-fotografi, Arkitekturë, Martesa e ngjarje sociale, e shumë të tjera. Unë ndër këto që i përmenda i favorizoj Fotografimin artistike (Fine art), Makron, Portrete etj. Dy kategoritë e mia të favorizuara po nënkuptohen nga emri që mbajnë, ndërsa Makro është kategori që si objekt fotografi merr detajet si psh: zogjtë, lule, koka e ndonjë insekti, objekte të ndryshme etj. Është kategori e cila kërkon pajisje të shtrenjta fotografuese.

Për të parë fotografitë e mia ju sugjeroj të klikoni www.flickr.com/photos/agronberisha/

Në fund, i përhëndes të gjithë studentët dhe profesorët në UBT, njëkohësisht studentëve ju dëshiroj sukses në teste dhe provime.

Edhe menaxhere edhe këngëtare



“Dëgjoni muzikë. Muzika është gjëja më inspiruese për tejkalinin e stresit dhe mbingarkesës. Ia vlen që të mësojmë dhe të dalim kokëlartë nga një fakultet i stërbushur me vlera si UBT”, thotë Lirigzona Morina, studente e vitit parë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

“Gjithçka që më rrethonte e dëshiroja rreth meje dhe për mua. Pikturoja, lexoja, aktroja, fotografoja, por e këndimin e veçoja”, thotë Lirigzona Morina, studente e vitit parë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në

Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Ajo qysh në moshë të re dhe me përkrahje të prindërve fillon të merret me muzikë, duke organizuar korin e fëmijëve dhe këndon si solo këngëtare nëpër koncerte që organizonte Gjimnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë.

“Nuk është që muzika dhe biznesi kanë ndonjë lidhje të ngushtë, por nuk do të thotë të jesh një “Successful Business woman”, e të mos mund të jesh një këngëtare e famshme”, thotë Lirigzona, të cilës i pëlqejnë të gjitha zhanret e muzikës si blues, country, rock dhe argëtuese.

“Preferoj të këndoj këngë të këngëtarëve që karakterizohen për vokalin e tyre të fuqishëm si: Celine Dion, Toni Braxton, Shania Twain, Leona Lewis, Rona Nishliu dhe veçanërisht Grupi

“Troja” për tekste dhe temat që ata i shtellojnë në këngët e tyre gjithmonë duke menduar gjenden në të cilën shteti ynë po ndodhet”, tha ajo.

“Shfaqjet në të cilat kam marr pjesë dhe koncertet që kam kënduar do të mbesin gjithmonë si nisma ime më e bukur e ëndrrës time”, pohon Lirigzona.

Lirigzona pret ofertë që sa më parë ta përfaqësoj Universitetin UBT, në ndonjë garë apo ta përgatitë e një këngë kush-tuar UBT-së.

“Është privilegj që unë jam pjesë e një universiteti të mrekullueshëm si UBT, do e përfaqësoja me krenarinë më të madhe në çfarëdo gare, dhe do ta realizoja këngën gjithmonë duke ditur që UBT është më të vërtet vendi i vlerave dhe i arsimimit të lartë”, thotë ajo.

Profesioni i Lirigzonës në të ardhmen do të mbetet biznesi edhe pse ka talent për muzikë.

“Në të ardhmen veten e shoh si një menaxhere të suksesshme ndoshta edhe me pak famë nga muzika”, thotë Lirigzona.

“Mesazhi im për kolegët e fakultetit do të ishte të mësojnë sa më shumë për shkak të kushteve të mira dhe moderne që kemi në UBT, të dëgjojnë muzikë sepse në rast mbingarkese muzika është gjëja më inspiruese për tejkalinin e stresit. Ja vlen që të mësojmë dhe të dalim kokëlartë nga një fakultet i stërbushur me vlera si UBT”, përfundoi ajo.

Rrugët e qytetit tim

NASUF ISUFI

UBT-MBE , Viti i I-rë

Vendosa të dilja në fundjavë në ditën e shtunë. U bëra gati me rrobat më të përshtatshme për ti rezistuar atij të ftohti që mbretëronte në qytetin tim. Telefonova madje edhe miqtë, me të cilët nuk isha takuar një kohë të gjatë. Duke ecur rrugëve të qytetit me shokët e mi, dëgjua një zë të lartë që ta ngacmonte veshin, ndihmë, më ndihmoni. Përnjëherë na u ndal buzëqeshja. Iu afruam atij djaloshi i cili po qante me një zë rrëqethës, me lotët e tij që ta thyenin zemrën. Iu afruam dhe e pyetëm çfarë ke? Pse



je në rrugë?

Djaloshi vazhdonte të qante, duke mos folur as edhe të vetëm fjalë. U larguam por me kokën e kthyer kah djaloshi me fytyrë të skuqur dhe me sy të përplotur.

Ne prapë vazhduam rrugën, dhe pas disa hapa ne një cep të rrugës, aty pran një ndërtesë që shkëlqente nga bukuria e që ishte e banuar nga pasanikët e qytetit. Pikërisht aty afër ishte kontinieri i ndërtesës afër te cilit dilte një tym i

fuqishëm. Menduam se po digjej ndonjë gjë, por jo! Aty ishte një i moshuar që ngrohej me disa letra të hedhura nga banoret e lagjes. Ishte një njeri i moshuar, një njeri i zbathur me rroba te grisura. Provuam të bisedonim, por pa sukses. Menduam se nga të ftohtit nuk mund të fliste, por që më vonë doli të jetë se ishte shurdh-memec, e me e keqja për te ishte se nuk kishte te afërm, madje ishte edhe pa kulm mbi kokë.

Vazhduam rrugëtimin, rrugës hasnim në raste të ngjashëm, fëmijë në rrugë, të moshuar, pa gjymtyrë e shumë raste te tjera. U kthyem në shtëpi tona te ngrohta, por jo të gëzuar, pasi që në mendjen ton silleshin fytyra të njerëzve që kishin nevojë për ndihmë dhe me ata zëra që ta thyenin zemrën dhe vazhdojnë te ndikojnë në ndërgjegjen tonë.

Simbolika e grafikave

HIVZI MUHARREMI

Fatmir Krypa i takon brezit të vjetër të krijuesve figurativ, brez i cili ka luajtur rol parësor në zhvillimin e arteve pamore në Kosovë, brez i cili padyshim, ishte bazament i zhvillimit të të gjitha vokacioneve artistike në Kosovë. Është pjesëmarrës mbi qindra ekspozitave kolektive si në Kosovë po ashtu edhe në qendra të ndryshme evropiane, si dhe të atyre personale. Është laureat i shumë shpërblimeve si në vend ashtu edhe jashtë Kosovës. Themelues i Departamentit të grafikës në Fakultetin e Arteve.

Në fletëgrafikat e para të ciklit "Bashkëkombës të mi", nga faza e parë, Krypa ishte frymëzuar nga fati i njerëzve, të cilët me punën e mundimshme, përmes travajave dhe kërkimeve për ekzistencën e familjeve të veta, që vuanin për kafshatën e gojës, nëpër rrugët e qyteteve të mëdha e të pafund e siguronin bukën, veshmbathjen etj., tani Krypa fillon të frymëzohet nga motive që janë ekskluzivisht autentike dhe karakteristike për këtë mjedis. Nga femra e mbuluar me shami të bardhë dhe të veshura me çarçafë të zinj, të bëra tebdile, të moshuara, për t'i ikur shikimeve të huaja, si pasojë e trashëgimisë shekullore të sundimit otoman në Kosovë. Pra, cikli i "Tebdileve" (1976) shpreh një kontradiktë të kohës ekzistuese, progresin dhe regresin.

Një emancipim i denjë dhe i vërtetë i femrës shqiptare has në kundërshtim me doket dhe zakonet e kohëve përkatëse. Disa sugjerojnë këto doke e zakone, e ca të tjera e mbrojnë. Aty obsidohet – zhvillohet një dialog i tebdileve, e që në atë kohë mund të venerohej nëpër rrugët e qyteteve dukagjinase, ndërsa sot, në masë të madhe kjo dukuri e prapambeturisë shekullore është zhdukur. Këto imazhe të trajtësuar nga Krypa kanë mbetur si



dëshmi të asaj kohe.

Struktura, hapësira e këtyre fletëgrafikave është e begatuar me raportin e dritë-hijeve e kolorititit dhe çdo fragment spikat me strukturë përmbajtësore. Aplikimi i ngjyrës mëton konotacion piktoral dhe në çdo fletëgrafikë është manifestuar me qëllim të orvatjes për arritje të efekteve piktorale mes piktorës dhe grafikës.

Peizazhi i imagjinuar i këtyre fletëgrafikave spikat dukjen e shkëputjes të një "fragmenti" nga Bjeshkët e Nemuna, duke kaluar në jetën e nesërme. Ky peizazh frymon dhe është sendërtuar në frymën e introduktit bashkëkohor si në tra-

jtesimin e formës, ashtu edhe të kompozimit, tipare këto që mund të vërehen në fletëgrafikat: "Malësore V", "Nostalgi", "Siluet malësoreje", "Shitëse e qilimave", "Shitëse e vezëve", etj. Në ca prej tyre trajtohet problemi social, ku shitësja e vezëve shet vezë për të arritur shkollimin e fëmijëve, të cilët obsidohen në rolin e bariut në një sfond diskret, që është komponuar mbi kokën e nënës, që rri prorre si brengë për ngritje të vetëdijes së brezit të ri. Karakteristike të "Malësorja me vezë" dhe "Silueta e malësore" është ngjyra e blertë, ndërsa e kafja është pjesë integruese në tërë këtë cikël, me

të Fatmir Krypës

veçim diç më të madh në fletë-grafikën e "Malësore V", të cilën e kundrojmë si vjelëse të mollëve, ndonëse veçohen figurat për nga veshja karakteristike autoktone të mjedisit dukagjinas ato përmes thyerjeve bashkëkohore kompozicionale, në frymën e stilit të grafikës (i shmangen) motivit imediat të folklorit. Të gjitha partiturat kompozicionale, fakturale, koloristike integrohen në një tërësi bashkëkohore figurative dhe autorit i japin një drejtim karakteristik.

Malësorët janë imazhe që trajtohen si tërësi e një cikli të mëparshëm, por me një ngërthim më të theksuar të qëndrueshmërisë së tyre nda rrebesheve kohore. Përkimi me traditën dhe qëndrueshmërinë e tyre stoike përballë fortunave më të furishme historike, por gjithnjë duke ruajtur identitetin kombëtar duke ruajtur e vazhduar çiltërinë e ndërgjegjes, ngritjen qytetare, e cila është vazhdimisht evolutive në jetën praktike, duke kundruar në emancipimin e tij personal dhe breznive të ardhshme.

Malësorit i interesojnë ndodhitë kohore ose ngjarjet ditore, ai paraqitet pranë imazheve ditore duke i vrojtuar. "Malësori me gjel" është paralajmëtar i një situatë të re kohore, e cila nuk është thjesht si kundrohej në fletëgrafikën "Shitësi i gjelit", por paralajmëtar i një situatë të re kohore, në një mëngjes të pastër e të kthjellët me një krenari duke lënë gjurmë në situatën e viteve ekzistuese. "Malësori dhe kullë" paraqet një qëndresë krenare, me obsidim nga një perspektivë, e cila depërton në kometa dhe pasqyron një perspektivë, gjë që pasqyrohet me një fragment të peizazhit të gjelbëruar. Autori i trajton këtu dy struktura, të cilat janë më tepër të imponueshme, strukturën e shallit dhe të linjave, e cila si element figurativ në grafikë është shumë e ndjeshme, strukturale, për ta ravigjzuar formën dhe

plasticitetin e materies. Vija është më e theksuar në këtë cikël vijues. Me anë të vijave materializohen peizazhi dhe strukturat e tjera të formave kompozicionale.

Në fazën e dytë të krijimtarisë së vet, Krypa bën përpjekje të futet edhe më thellë në tiparet specifike të kësaj treve, kështu që fillon një cikël tjetër, inspiruar nga veshmbathjet specifike të popullit që jeton e vepron në rajonin e Hasit, dhe e titullon "Hasjanë". Përveç veshmbathjes, në këtë cikël shihet qartë ambienti i Hasit me peizazh dhe motive të Rrafshit të Dukagjinit. Si për nga koloriti, ashtu edhe për nga forma, figurat kanë qenë të bashkuara me motive përkatëse. Kjo shihet më së miri në fletë-grafikën "Hasjane II", ku prezantohet një grua e kësaj treve, e veshur me veshje kombëtare, duke u larguar nga shtëpia më kënatë në dorë, sigurisht për të sjellë ujë. Figura paraqitet në pjesën qendrore të kompozicionit, si dhe me elementet e kodrinës dhe të shkëmbinjve në pjesën e sipërme të kompozicionit.

Pas këtyre cikleve, pason cikli i ri i "Kullave", si vazhdimësi e shprehjes individuale të një tërësie që rrah një problematikë si për nga forma kompozicionale, ashtu edhe për nga shprehja ideore.

Në fletëgrafikën "Kullë e meteor" pasqyrohet kulla dhe një meteor mbi të, si sinonim i peshës së kohës që u ka rënë kullës dhe njerëzve të saj, të cilët nuk gjunjëzohen në asnjë çast, por,, përkundrazi, ngadhënjajnë mbi kohën. Kullën nuk e obsidon si formë e një motivi karakteristik shqiptar, por ajo rrahë një problematikë më përmbajtësore, qëndresën e njerëzve përballë kohëve më të vështira për kombin shqiptar. Këtë mund ta pasqyrojë edhe fletë-grafika "Kulla e pamposhtur" e cila qëndron në një hapësirë të pasur e pamposhtur, krenare, me një peizazh me mpleksje të jetës së

vështirë e të rëndë të fshatarit, por ideologjia e tij është krenare dhe e pamposhtur. Dramën kohore të këtij mjedisi, njëherësh e pasqyron një peizazh me ngjyrë të gjelbër në të mbyllët, me bjeshtë të mbyllët, por, me trajtësim të një kulle të bardhë, të theksuar, e cila është sinonim i pastërtisë shpirtërore të njerëzve të saj. Te "Kulla e vetmisë, vihet re ngjyra e kuqe e zjarrtë e meteorit, e cila nuk e frikëson as njeriun, as kullën, ajo mbetet vazhdimësi e shekujve.

Në të gjitha këto cikle të gjertanishme është vërejtur aplikimi në mënyrë mjeshtrërore i teknikës së akuatintës me ngjyrë, në një segment të këtyre cikleve autori bënë pauzë dhe kërkon zgjidhje që problemet ideore, artistike, teknike t'i realizojë në teknikën e seriografisë. Këto mund t'i vërejmë më së miri në fletëgrafikat: "Kështjellë" dhe "Lis i moshuar". Në këto fletë-grafika ngjyra është më intensive, karakteristike janë ngjyrat e gjelbër, e kuqe dhe e verdhë. Ndërsa, ngjyra bardhezi është poashtu një segment i cili bashkëlidhet, si karakteristike e atyre kullave të mëparshme, me një kontrast dritë-hije më të theksuar.

Vazhdimësia teknike e seriografisë pasqyrohet edhe në fletë-grafikat "Ëndrra e Afërditës" dhe "Agu nuk është larg". Në fletë-grafikën "Zgjimi i Afërditës", pasqyrohet një siluetë vashe, e cila ndriçohet gradualisht dhe me hapat e vet të parë orvatet të ngrihet në një vetëdije të gjithanshme shkencore. Në plan të parë vihet re një arkë e porsahapur, e cila shpjegon daljen e femrës shqiptare nga një arsye shekullore, ku obsidon pranë saj dritarja si asociacion i pasqyrimin të gjithësisë. Ngjyrat karakteristike janë okër, e kaltra, bardhezi dhe umbre. Rëndësi të veçantë i kushton kundrimin struktural të arkës dhe të hënës. Ndërsa në fletëgrafikën "Agu nuk është larg" pasqyrohet një peizazh i një

mëngjesi të qetë në një sfond të kaltër të mbushur me hëna të imagjinuara, të cilat trajtojnë lindjen e transformimit të hënës nga një errësirë në një hënë të ndritshme. Në qendër obsidon figura e hutit me ngërthim shqetësimi duke pritur mëngjesin për të fluturuar, për t'u ngritur lartë shtigjeve malore. Zgjidhja kompozicionale është parashtruar në një peizazh bashkëkohor me elemente që kujtojnë trugje të hedhura në gjethe dhe infrastrukturë të mishëruar në atmosferën e qetë të një muzgu. Sfondi me një ngjyrë të kaltër na imponohet si karakteristikë e veçantë e kompozicionit, që dallon rrënjësisht nga fletëgrafikat e mëparshme. Ndonëse kundrohen disa partitura më dekorative të një koncepti që trajtohet më tepër në teknikën e seriografisë.

Imazhet më karakteristike që transponohen në fletëgrafikat e Fatmir Krypës njëherësh evokojnë ngjarjet më aktuale të një situatë momentale: "Ndërtimtarë të paqes", "Zogu i lirë", "Përrirje e trungut ilir", "Dritaret e mbyllura", "Punë fitimtare", "Zgjimi i foshnjës", "Arkë dhe qershi". "Ndërtimtarët e paqes" pasqyrojnë një siluetë të një femre ku në pjesën qendrore obsidon një siluetë mbi derën karakteristike të një fshatari me dy figura duke murosur një paqe për kohët e ardhshme. Në pjesën e sipërme si fragment i kësaj teme kundrohen ca elemente bashkëkohore të peizazhit, të cilat shfaqin florën e faunën e kësaj hapësire. Si pjesë më karakteristike e gjertanishme është prerja e pllakës së zinkut në formën e siluetës, e cila karakterizon një pemë mistifikuese. Në fletëgrafikën "Zog i lirë" plekset simbolika e kërkesës së lirisë përmes zogut të gjelbër, i cili fluturon lartë në qiell. Kjo manifestohet me një hapje të një syze, dikur të mbyllur, në një sfond që sugjeron zgafellen plotë me struktura interesante, të cilat kanë një karakteristikë si për nga struktura teknike, ashtu edhe për nga përmbajtja ideore. "Ngritja e zogut në qiell" ka një sfond të ngjyrës së kaltër në të kuqe, ku



vërehet shpresa e idealeve. Është realizuar në teknikën e akuatintës me kombinim të teknikës së shtypit të rrashtë. Që të dyja këto teknika janë fuzionuara në një tërësi kompozicionale. Grafika "Përrirje e trungut ilir" është një vepër, e cila reflekton një përrirje të së ardhmes sonë kombëtare.

Duhet cekur, se autori në vijimësi të cikleve do t'i trajtoi tema nga aktualiteti kohor, ku padyshim këto fletagrafika do të arrijnë një avansim dhe metamorfozë të dukshme duke filluar nga veprat "Bashkimi i trungut ilir", "Homazh i të pagjeturve", "Newborn" e deri të cikli "Format strukturale", që përmban një numër të konsiderueshëm të fletëgrafikave me ngërthim të bollshëm të motiveve dhe imazheve, si dhe me aplikim të hollësive bashkëkohore, që ka njëherësh lidhmëni në aspektin kontinual

zhvillimor me fletëgrafikat e cikleve më të hershme, por me një avansim të dukshëm në artikulum të elementeve figurative të konceptit ku trajtohen ngjarjet dhe ndodhitë kohore më aktuale. Ngjyra në këto vepra është më e theksuar, më studioze dhe mbron një shkrimje të një game specifike për çdo fletëgrafikë në veçanti. Në të gjitha këto vepra autori shquan me një ndjeshmëri strukturën, përkatësisht elementet e formave të modeluara me kujdes.

Në fund do thënë, autori përmes fletëgrafikave të prezantuara e shpreh botën e vetë sa suptile po aq edhe ekspresive me ngjarje dhe përjetime të llahtarshme që ndodhën dhe u përjetuan në ambientin kosovarë, e sidomos gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Autori është mësimdhënës në UBT, Departamenti i Arkitekturës.

Mesiqi - "Qytetar nderi" i Prishtinës

BESARTA SOPI

Vendi ynë kishte nevojë për përkrahje dhe mbështetje në hapat që po ndiqte për një rrugë të drejtë lirisë dhe pavarësisht. Në mesin e dashamirëve dhe përkrahësve tonë ishte edhe Presidenti i Republikës së Kroacisë, Stjepan Mesiq. Ai asnjëherë nuk hezitoi të shprehë se Kosova kishte të drejtat e barabarta me regjionet tjera duke e krahasuar edhe me vendet perëndimore. Mesiq, gjatë gjithë kohës ka përkrahur Kosovën për liri dhe pavarësi. Si mik i Kosovës ai tha që "Serbia duhet të kërkojë falje për atë që bëri në Kosovë".

Ai shprehej se Kosova shpall pavarësinë e saj dhe në këtë hapësirë u krijua një realitet i ri, realitet të cilin e njohën shumë vende. E, Kroacia ishte ndër vendet e para që njohu pavarësinë e Kosovës.

Për kontributin e tij për Kosovën dhe për ndihmën e tij dhe të popullit kroat që i dhanë vendit tonë, presidenti Mesiq morri titullin "Qytetar nderi i Prishtinës", ku u dekorua me dekoratën më të lartë "Hyjnesha ne



Fron", të cilën e ndan kryeqyteti i Kosovës.

Presidenti Mesiq shprehu falënderimin e tij për titullin e dhënë atij nga kryeqyteti.

"Këtë dekorim e shoh dhe e vlerësoj në kontekstin e vizitës time zyrtare, e cila është vizita e parë zyrtare e një presidenti të Republikës së Kroacisë në Republikën e Kosovës. Në të gjitha fushat dhe në marrëdhëniet tona po e hapim një kapitull të ri", tha presidenti Mesiq.

"E ardhmja jone është në bashkëpunim, dhe këtë e them si për Kosovën ashtu edhe për vendim tim

Kroacinë", theksoi ai.

Duke marrë parasysh kontributin e madh që Shkëlqesia e tij, President Mesiq e dha për Kosovën, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor të vitit 2009 mori: "Vendim për ta shpall qytetar nderi të Komunës së Prishtinës, për mbështetjen shumëvjeçare të Kosovës dhe të drejtës së popullit të saj për vetëvendosje dhe pavarësi".

Kreu i shtetit kroat shprehu gatishtërinë e shtetit të tij për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë edhe pas zgjedhjes së presidentit të ri të Kroacisë.

Kjo dekoratë "Qytetar nderi i Prishtinës" dhe dekorata më e lartë që i jepet personaliteteve, të cilët kanë dhënë kontribut të madh në çështjet nëpër të cilat ka kaluar dhe vazhdon të kalojë vendi ynë.

Isa Mustafa, kryetar i kryeqytetit të Kosovës ndau edhe çmimin "Hyjnesha ne Fron" për presidentin Mesiq.

"E vlerësoj kontributin tuaj për çështjen e Kosovës, dhe përkrahjen që dhatë gjatë proceseve që po kalonte Kosova", tha Mustafa.

UBT e ka anëtarësuar Kosovën në OEC, IFAC, IPMA

KONTRIBUTI I UBT-SË

Përmes Universitetit për Biznes dhe Teknologji, Kosova sot është e anëtarësuar në tre organizmat më të mëdha botërore. "Kosova është bërë anëtare në Organizatën Ndërkombëtare për Cilësi (OEC), në Federatën Ndërkombëtare të Kontrollit Automatik (IFAC), si dhe në Organizatën për Menaxhimi i Projekteve (IPMA). Po ashtu në UBT është mbajtur Kampionati "Euroby 2009", dhe Kosovën e ka përfaqësuar UBT-ja", tha Edmond Hajrizi, rektori i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) në kumtesën e tij voluminoze në konferencën shkencore "Java e shkencës" të organizuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

UBT është ka jep kontribut në fusha e cekura më lartë, dhe në mënyrë të vazhdueshme është ka organizon konferenca shkencore, debate, forume, certifikime etj. "Në fushën e hulumtimeve Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) ka strategjinë 2008-2011 duke përfshirë në të mjaftë fusha dhe me tetë grupe

punuese. Kemi përfshi fushat e shkencave aplikative se përmes hulumtimeve domeni aplikativ mund të kontribuohet ma shpejt te zgjidhja e problemeve ekonomike e sociale, gjërave që neve na ndihmon direkt për zhvillimin e vendit", tha Hajrizi. "Edhe në fushën e robotikës dhe mekatronikës jemi ka punojmë dhe kemi punuar mjaftë shumë dhe kemi laboratorin mjaftë modern fal kontributit të Unionit Evropian dhe investimeve të tyre dhe sot në Kosovë pikërisht në UBT ekziston një laborator mjaft modern ku bëhen edhe trajnime të gjitha elementet e nevojshme janë aty", laboratori në fjalë është arritur bashkë me partnerët ndërkombëtar si Austria, Gjermania, Italia, Irlanda, etj.

KOSOVA PO PUNON NË DREJTIM TË SHKENCËS SIKURSE BOTA E ZHVILLUAR

Prej 2003 UBT ka bërë vizita të vazhdueshme në SHBA dhe në Evropë, në kompani, institucione dhe universitete të ndryshme. Vitin e

kaluar është mbajtur kampionati i robotëve në Kosovë dhe Ekipi UBT e ka përfaqësuar në mënyrë sa më shkencorë Kosovën për teknologjinë e aritit më moderne në rajon dhe botë. "Kjo garë ka akceptuar se Kosova është ka punon në drejtim të shkencës sikurse bota e zhvilluar", ka thënë Hajrizi. Ai tha se UBT-ja është mundura që Kosova të jep kontributin e përgjithshëm jo vetëm individual por përgjithësi për vendin dhe më gjerë p.sh Universitete për Biznes dhe Teknologji në aspektin shkencorë dhe përmes UBT Kosova sot është e anëtarësuar në tre në organizmat më të mëdha botërore e ndërkombëtare, që i cekëm më parë. "UBT vazhdimisht po publikon libra dhe punime shkencore dhe faktikisht punimet tona të mbajtura gjatë konferencave në Kosovë janë publikuar komplet në revistat ndërkombëtar shkencore, po ashtu UBT vitin akademik do 2010/2011 do fillon ne objekt te ri universitare, përveç objektit universitar aty do ndërtohet edhe instituti etj.", ka përfunduar Hajrizi.

Studion menaxhmentin – ëndërron pikturën

“Me 30 piktura dhe me disa fotografi do ta hapi ekspozitën personale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT)”, thotë Marigona Shala, studente e vitit parë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi



Marigona Shala shkollën e mesme e ka përfunduar më sukses të shkëlqyshëm në Gjymnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Tash është studente e vitit parë në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi të Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT.

“Pikturën, përkatësisht në përgjithësi fushat e artit i dua dhe i punoj me zell gjithmonë”, thotë Marigona, e cila prej shkollës fillore merret me pikturë dhe me fotografi.

Stili i pikturimit të saj është me vaj në pëlhurë. Deri më tash ka punuar një mori pikturash, të cilat kohë pas kohe edhe i shet. Ka edhe punime të tjera të vizatuara me laps, sidomos portrete, por edhe mozaike me gurë.

“Çdo gjë që më rrethon për mua është inspirim për vepra të reja, sepse bota e artit është e lidhur ngushtë me botën që na rrethon, botë kjo që piktori e zbukuron. Natyrisht se botën duhet ta paraqesim në mënyrë reale duke e

pasuruar me përmbajtje artistike”, thotë Marigona.

Piktura e Marigona Shalës më shumë ka të bëjë me tema të çështjes kombëtare.

“Më pëlqejnë dhe më preokupojnë motivet kombëtare, portretet, peisazhet e motive të tjera, por që të gjitha mendohem t’i kombinoj me artin modern”, shton Marigona. Marigona Shala së shpejti do të hap ekspozitë personale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji – UBT. Në ekspozitë planifikon t’i ekspozojë rreth 30 punime, ku nuk do të ketë vetëm piktura, por do të ekspozoj edhe fotografi artistike.

“Më pas kam një projekt rreth një mozaiku, i cili do të jetë shumë unikat, ku do të pasqyroj talentin tim si artiste”, thotë kjo studente dhe piktores vyeshe.

Marigona nuk e përjashton edhe mundësinë që të bëhet pjesë edhe e ndonjë ekspozite kolektive, sepse ajo bashkëpunimin e sheh si mundësi për

hapësira të reja.

“Pikturën klasike, e në veçanti piktorët e renesancës, si Leonardo da Vinçin, Mikelangjelon, Ticianin, e të tjerë, më pëlqejnë jashtëzakonisht. Por, ajo nuk e përjashton as artin modern, sidomos pikturën e Picasos”, thotë Marigona.

Ndërkaq nga piktorët shqiptar i veçon Pjerin Sheldin, Muslim Mulliqin, Zake Prelvukajn, Fatmir Haxhiun, sepse siç thotë ajo, ata “janë të veçantë për nga stili dhe mënyra e pikturimit, por dallojnë edhe për nga zgjedhja e motiveve, sidomos ato kombëtare”.

Megjithatë, profesioni i Marigonës në të ardhmën duket se do të mbetet piktura, sepse, siç thotë ajo “UBT-ja është mundësi e mirë të arrijë atje ku pretendoj, mirëpo piktura do të jetë ajo pjesë e profesionit tim që do ta vazhdoj. Për pikturën do të angazhohem, edhe pse tani si hobi, por në të ardhmën ndoshta do ta kem profesion”, përfundon Marigona.

UBT edhe me ekip basketbolli

Ekipi i basketbollit UBT u formua në fund të vitit 2009. Trajneri është Shkumbin Shahini, ish student i UBT, tashmë menaxher në zyrën e trajnimeve në UBT. Pjesë e ekipit janë 9 lojtarë-studentë: Arian Ruhani, Rron Deri, Kushtrim Grajqevci, Shkelqim Lipovica, Kreshnik Ismaili, Pajtim Thaqi, Granit Ramadani, Agon Ismaili dhe Herolind Dreshaj.

UBT News: Kur u themelua ekipi i basketbollit dhe e kujt ishte ideja?

Shkumbin Shahini: Ekipi i basketbollit UBT u themelua në dhjetor të vitit 2009.

UBT News: Cilat janë sukseset

e deritashme dhe a keni qenë pjesëmarrës në ndonjë garë?

Shkumbin Shahini: Deri më tani nuk kemi marrë pjesë apo të themi se nuk kemi zhvilluar ende asnjë ndeshje për arsye se nuk ka filluar ende liga e universiteteve, pra që do të thotë se sukseset priten të regjistrohen në sukseset e tjera të UBT-së.

UBT News: Keni ndonjë basketbollist profesionist në ekipin tuaj apo ndonjë tjetër që premtan se mund të arrijë sukses në këtë sport në të ardhmen?

Shkumbin Shahini: Kemi disa basketbollistë që luajnë në ligën e dytë të basketbollit kosovar. Por, jo

vetëm prej tyre, po nga të gjithë lojtarët pritet një sukses i mirë për të ardhmen e UBT në lojën e basketbollit.

UBT News: Çfarë do të thonit për studentët tjerë, të cilët nuk janë në dijeni për këtë ekip dhe do të donin të ishin pjesë e tij?

Shkumbin Shahini: Krejt çka mundem të shtoj në pyetjen e fundit është se munden të vijnë e të na vizitojnë dhe të shohin me sytë e tyre se ku kemi qenë e ku kemi mbërri deri më tani sepse për një kohë të shkurt kemi mësuar shumë dhe stërvitje pas stërvitje jemi duke përparuar.



ANKETË ME STUDENTËT E UBT-SË

Sa jeni të kënaqur me gjendjen e përgjithshme në Kosovë dhe çka do të ndërronit?

Liberalizimi i vizave sjell zhvillim në shkencë, zhvillim arsimor, kulturor, ekonomik



AGRON KRASNIQI

UBT-MBE , Viti i I-rë

Nuk mund të themi se gjendja në Kosovë është e kënaqshme deri në atë masë sa që populli të ishte optimist për vendin e tij dhe me kushtet e një shteti demokratik. Mirëpo, gjithashtu nuk mund të themi se gjendja në Kosovë është një katastrofë apo diçka tmerruese, kur dihen pasojat e pasluftës që Kosova i ka përjetuar, ku është shkatërruar pothuajse në tërësi. Dhe duke krahasuar periudhën e shkurtër të daljes nga lufta dhe shpalljes së Kosovës shtet i pavarur më 17. 02. 2008. ne mund të mburremi me përparimet e shtetit tonë në të gjitha aspektet. Ka mungesa të ndryshme në institucionet tona qeveritare, si joprofesionalizmi në punë, pagat e vogla krahasuar me shtetet e rajonit, papunësia e madhe etj, ku dihen se këto janë me kryesorët për të qenë një shtet i fuqishëm. Gjithashtu ne si kosovarë nuk kemi mundësi të lëvizjes së lirë nëpër shtetet perëndimore për shkak të mos liberalizimit të vizave ku edhe kjo është një mundësi e zhvillimit si arsimor si kulturor, ekonomik dhe në shumë aspekte tjera. Por duke shikuar nga

këndi tjetër Kosova çdo ditë e më shumë është duke u zhvilluar dhe kushtet momentale si të jetesës, arsimimit, sigurisë etj, janë të mira deri në një pikë të kënaqshme për popullin të Kosovës. Sidoqoftë, kemi një rini të shëndoshë dhe të edukuar e me shumë vullnet të cilët kemi të gjithë se bashku një vizion e një mendim për zhvillimin e mëtutjeshëm të vendit tonë. Dihet se rinia është si një lloj pasqyre e një shtetit dhe për fat të mirë ne si rini presim dhe kemi të gjitha të mirat nga Kosova. Çka do të ndërroja në Kosovë .. shumë gjëra e pak përmirësime. Ato shumë gjëra janë: Ekonomi më të shëndoshë dhe më të zhvilluar, punësim më të lartë, zhdukje të varfërisë dhe skamjes, sigurime shëndetësore të qytetarëve, rritje të pagave etj. Ndërsa ato pak përmirësime që do të kisha bërë janë: ulje të tatimeve të qytetarëve, integrim më të shpejtë të Kosovës në Europë, rrymë dhe ujë të mjaftueshëm e përkushtim më të madh të pushtetarëve ndaj popullit, gjithashtu realizimin e kushteve më të mira dhe plotësimet e premtimeve të tyre.

Duhet të respektohet ligji



ARBNORA GASHI

UBT-MBE , Viti i I-rë

Nuk jam as politikane, as ekono-

miste. Por, nga ajo që po e dëgjoj gjatë udhëtimit tim të përditshëm nga fshati në qytet, gjendja e përgjithshme në Kosovë është në lëvizje pozitive por e pasigurt.

Sipas mendimit tim këtë e shkakton mungesa e ligjeve dhe zbatimi i tyre.

Sa kam vështruar, të pakta janë ato institucione që nuk e thyjnë rregulloren e vet-nxjerrë. Si ilustrim po përmendi Universitetin e Prishtinës, që duhet të ishte shembull për punë korrekte e të drejtë. Edhe ky institucion thyen rregulloren e vet duke pranuar student jashtë rregullores e duke lënë anash ata të merituarit.

Kështu edhe në QKUK e në shtëpitë e shëndetit që shikova e kërkova ndihmë për të sëmurit, nuk gjeta trajtim të mirë sidomos nga ata që kanë ordinanca private. Arsyet dihen! Ata punojnë vetëm sa për të fituar pacient me arsyetim se në spital nuk ka aparate e kushte pune. Shumica nuk e kryejnë detyrën e mjekut por të ndërmjetësimit me ordinancat private.

Në zhvillimin ekonomik shumë pak shoh anë pozitive. Shumica merren me tregtinë e mallit që importojnë ndërsa prodhimi është shumë i vogël, që reflektohet edhe në punësimin e qytetarëve dhe sigurinë e tyre. Të rralla janë organizatat që punojnë me kontrata të mirëfillta pune. Të gjitha janë të përpiluara në llogari të punëdhënësve e jo edhe të punëtorit.

Keqpërdorime ka shumë, por ajo që më mundon më së shumti është keqpërdorimi institucional, që me vetëdije e dëmton popullatën në vend që ta ndihmojë atë. Njëjtë vepron edhe KEK-u. Me fatura në

dëm të konsumatorit pa respektuar të drejtën e tij.

Këto janë vetëm disa gjëra që kërkojnë ndryshim, po në rend të parë do të kisha kërkuar ligje e rregullore që e mbrojnë, por edhe e detyrojnë si qytetarin ashtu edhe institucionet, si dhe krijimin e mekanizmit për zbatimin e tyre. Përmes kësaj besoj se edhe popullata do të vetëdijësohet për të kërkuar drejtën e vet përballë atyre që kërkojnë obligime.

Nuk është demokraci veprimet në dëm të tjetrit. Nuk është drejtësi shpalosja e kërkesave e jo edhe e obligimeve ndaj qytetarit. Kjo duhet të jetë e dyanshme: sa kanë obligime qytetarët ndaj institucioneve, aq edhe institucionet duhet të ofrojnë kushte dhe ti kryejnë obligimet e veta ndaj qytetarëve dhe për moskryerjen e obligimeve duhet ndëshkuar si njëriën ashtu edhe tjetrën.

Kjo do të mundësonte ndryshimin në të mirë të gjendjes në Kosovë.

Papunësia konsiderohet sëmundje e rëndë ekonomike



BLERINA HOTI

UBT-MBE , Viti i I-rë

Jam e kënaqur pjesërisht me situatën e përgjithshme në Kosovë. Edhe pse në Kosovë ka mjaft të aritura në shumë fusha jetësore por prapëseprapë ka mjaft për t'u bërë që ne të kemi një jetë më të mirë në përgjithësi.

Meqenëse, jam studente e vitit të parë pranë Kolegjit UBT, ku studioj në degën Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, kam krijuar bindjet e mija se si mund të zhvillohet dhe të për-

parojë një vend në fushën ekonomike. Duke pasur parasysh që çdo qeveri e ka për obligim që t'i përcjellë me vëmendje zhvillimet në vend në periudha të caktuara ku në bazë të të cilave edhe përcaktohet sukcesi apo mosesukesi i Qeverisë në raport me periudhën e njëjtë të mëparshme.

Çdo qeveri ka objektivat e saja zhvillimore, unë personalisht do të kisha synuar të ndryshojë në mënyre thelbësore qasjen ndaj problemit të papunësisë e cila konsiderohet si sëmundje e rëndë ekonomike. Mendoj se kjo mund të arrihet nëse krijojmë kushte më të favorshme për të gjithë ata që dëshirojnë të fusin në treg kapital të freskët me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës sidomos në sektorin prodhues. Me këtë kuptojmë se çdo produkt i ri në Kosovë ndikon në zvogëlimin e importit, zvogëlimin e papunësisë, nëse produkti i plotëson standardet e tregut ndërkombëtar mund edhe të eksportohet ku me këtë ndikon në rritjen e eksportit dhe përmirësimin e bilancit tregtar. Por nëse pari duhet të pretendojmë që së paku të prodhojmë për vete duke i plotësuar kërkesa në tregun kosovar me produkte të cilat nuk kërkojnë investime të mëdha dhe kanë një treg të garantuar në vend. Shpesh kam lexuar për konsumimin e produkteve vendore përmes shtypit dhe mediave elektronike apo ndonjë panairi i produkteve vendore. Mendoj se kjo nuk është e mjaftueshme sepse ndodhë rrallë. Mendoj se mediat elektronike janë mjet i fuqishëm për reklamimin e produkteve vendore. E kuptoj se çmimi i reklamave është i shtrenjtë e ndoshta për disa prodhues edhe i papërbalueshëm. Për këtë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të marrë hapa konkret që të arrihet ky qëllim qoftë edhe me beneficione apo donacione të ndryshme.

Rol kyç në zhvillimin ekonomik luan edhe politika fiskale e një vendi, edhe pse jam në hapat e parë të studimit kam vërejtur se tek ne ekziston një politikë fiskale pak sa e ngurtësuar e cila gjeneron të hyra kryesisht nga doganat, akcizat dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Kur e për-

menda fjalën ngurtësim mendova për ndryshimin e politikave doganore me qëllim të nxitjes së investimeve, te TVSH-ja do të kisha aplikuar tarifa të ndryshme duke lehtësuar disa produkte dhe në të njëjtën kohë duke i ngarkuar produktet tjera që i përkasin konsumit të ashtuquajtur luks si duhani, lojërat e fatit, alkooli e të ngjashme. Këto lëvizje në asnjë mënyrë të mos e dëmtojnë buxhetin e Kosovës por përkundrazi të ndikojnë në rritjen e tij.

Shpresoj se vitet në vijim do të na sjellin një zhvillim më të shpejtë dhe të qëndrueshëm.

Një popullatë e arsimuar do të thotë ngritje e kulturës e vetëdijes së shtetit



LIRIJE MUJA

UBT-MBE , Viti i I-rë

Si çdo gjë në zhvillimin e kësaj bote sa ka anën pozitive gjithmonë do të ketë edhe atë negative. Me gjendjen e shtetit tonë për dallim nga vitet që i lamë pas janë bërë zhvillime të hovshme në sfera të ndryshme. Zhvillimet që janë bërë në përmirësimin e vendit kanë reflektuar një kënaqësi për të gjithë ne. Një zhvillim shumë më rëndësi për çdo popullatë në botë është arsimimi i rinisë, një popullatë e arsimuar do të thotë një ngritje e lartë e një niveli të kulturës dhe vetëdijes së ati shteti. Arsimimi në vendin tonë ka arritur një shkallë të lartë sepse shumica e të rinjve pasi që mbarojnë shkollimin e mesëm ata ju qasen studimeve. Kjo arritje e arsimimit na nevojitet sepse përmes tij ne arrijmë atë çka ne dëshirojmë të bëhemi në jetë. Mëso që të arrish dhe të vetëdijësohesh për veten tuaj dhe më pas shpërndaje dijen tënde të

tjerëve që kanë nevojë për të. Ne si popull duhet të mburremi me rininë që kemi shumë të talentuar dhe ambicioze, rinia e shëndosh sjellë një të ardhme të ndritur për vendin. Sikurse çdo vend që ka nevojë për përmirësimin e gjërave në vend edhe vendi ynë do të kishte mundësi të përmirësohet më ndërrimin e disa gjërave, shpresojmë që me kalimin e kohës do të përmirësohen edhe të metat e vendit tonë. Ne jemi një popull që kemi mundësi të arrijmë atë që kërkojmë dhe e duam.

Përparësia jonë është rinia



HALIL NALLBANI

UBT-MBE , Viti i I-rë

Kosova në procesin e ndërtimit të themeleve të shtetit të ri është e orientuar që të ndërtohet si shtet i ri modern dhe europian. Për t'u ndërtuar si shtet modern dhe europian së pari duhet rritet ekonomia dhe të ulet papunësia. Gjendja ekonomike e tanishme në Kosovë mendoj që nuk është edhe aq stabile sepse për të rritur ekonominë na duhet një menaxhim i mirë dhe i efektshëm ndërmarrjeve e pronave shoqërore. Duhet të investohet maksimalisht në sektorin e bujqësisë sepse sektori në fjalë e ngritë ekonominë e vendit tonë dhe hapë vende të reja të punës. Nuk duhet të shkojmë në të gjitha sektorët drejt privatizimit, sepse në qoftë se vazhdojmë kështu Kosova do të humb në këtë aspekt, pasi nuk po tregon sukses kjo shkallë e privatizimit në vendin tonë. Mendoj se për ta zhdukur këtë shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë duhet të hapen vende të reja të punës dhe kjo bëhet duke sjellë investi-

torë të jashtëm në vendin tonë dhe të punësohen të rinjtë sepse Kosova ka një rini shumë më të shëndosh duke krahasuar me vendet e tjera në rajon. Këtu është përparësia jonë për ta ndërtuar një ekonomi të lakmueshme.

Femrat në Kosovë të jenë më aktive në të gjitha instancat e shoqërisë



MERITA HOXHA

UBT-MBE , Viti i I-rë

Jeta në Kosovë është duke u zhvilluar më një ritëm të ngadalësuar pas shpalljes së Pavarësisë, por është ka zhvillohet një jetë normale dhe me standardet Europiane. Para dhjetë vitesh në Kosovë ka pas torturë, agresivitet, vrasje, arrestime, burgosje nga okupatori serb etj., e sot jetojmë të qetë, të lirë dhe të pavarur. Kjo jetë më pëlqen mua dhe me ndihmon të vazhdoj studimet në Kolegjin UBT. Pas studimeve shpresoj të punësohem në profesionin tim dhe t'i ndihmoj familjes dhe të kontribuoj për vendin tim. Në një të ardhme të afërt dëshiroj që femra në Kosovë të jetë më aktive në të gjitha instancat e shoqërisë, rinia të punësohen, studentët të jenë më të përkrahur nga institucionet shtetërore. Poashtu shëndetësia të jetë prioritet mbi prioritetet, sepse shërimi i sëmundjeve akute dhe kronike po bëhet me vështirësi. Të ndihmohen personat me aftësi të kufizuara dhe ata që kanë nevojë për asistencë sociale. Të hiqen vizat për në Europë dhe jashtë Europës. Kështu që edhe ne si popull të kemi të drejtat tona dhe lirinë e lëvizjes.

Google Buzz – një rival i ri për Facebook dhe Twitter



Google ka shpалosur një vegël të re që ju lejon në mënyrë automatike përcjelljen e njerëzve, ngjashëm sikurse në Twitter apo Facebook

Siç është dyshuar, Google është duke sfiduar Twitter dhe Facebook duke shpалosur Buzz, një botë krejtësisht e re brenda Google Gmail.

Por së pari natyrisht ju duhet të jeni në Gmail.. Google është duke racionalizuar sulmin e saj ndaj Twitter duke vënë në dukje atë që ne tashmë e dimë, me Tweets, mesazhet e Facebook dhe madje edhe me modën e vjetër të "email" , që të gjitha për të tërhequr vëmendjen tonë.

Google Buzz ju lejon që në mënyrë automatike të ndiqni njerëzit e afërt me ju- ndoshta kjo është një gjë e mirë dhe ndoshta është e keqe. Po, ndoshta do të ketë edhe një funksion për fotografi. Të gjithë në një që ju të mos keni nevojë që asnjëherë të largoheni nga Google.

Google Buzz në përgjithësi ka të bëjë me shkërbimin dhe me faqet e sociale, dhe sipas Googlerëve gjërat janë duke u bërë kaotike. Google është duke na detyruar që të bëjmë zgjidhje: ne mund të punojmë ose mund të shëtisim nëpër rrjetet sociale.

Në thelb, Google dëshiron çdo gjë. Dëshiron të vrasë konkurrencën e celularëve, dëshiron të vrasë sistemet operative konkurruese, dëshiron rrjetin e saj social, me një fjalë dëshiron të jetë mbret!

E gati se harruam, Buzz punon edhe në pajisje mobile.

A do të sjellë Google një Tablet për lexim elektronik? Padyshim që po.

Google me të vërtetë e ka marrë seriozisht detyrën e Microsoft-it të shekullit 21 dhe pyetja e vetme e vërtetë është kur do të fillojnë qeveritë që ta nokautojnë, sepse këtë e kemi parë deri më tani apo jo... /ipko.net/

Apple prezanton iPad



Shefi ekzekutiv i Apple, Steve Jobs prezantoi javë më parë kompjuterin e ri tablet, me emrin iPad.

“Çfarë bën kjo pajisje është e jashtëzakonshme”, tha Jobs.

Sipas CNN, kjo tabletë do të jetë një lidhëse ndërmjet një smart-phone dhe një llaptopi.

Jobs e ka quajtur iPad’in, një “produkt me të vërtetë magjik dhe revolucionar”.

Sikurse një iPhone, kjo pajisje do të përkrah 3G dhe Wi-Fi, sikurse që do të përkrah aplikacionet nga App Store i Apple në iTunes.

iPad ka një ekran prej 10 inch ndërsa do të jetë në dispozicion me kapacitet 16 Gigabajt dhe 64 Gigabajt, sipas Jobs.

iPad pritet të ringjallë tregun e e-lexuesve duke prezantuar librat, gazetatat dhe artikujt e magazinave në ekranin e saj me ngjyra.

Karakteristikat e iPad

iPad është një pajisje e re e trashë gjysmë inç dhe peshon vetëm 0.68 kilogram, e ka një ekran IPS LCD capative të ndjeshëm në prekje me madhësi 9.7 inç, dhe punon mbi procesorin e veçantë 1GHz Apple “A4” që është dizajnuar nga ekipi P.A. Semi, dhe si tërësi pajisja ofron 10 orë pune përmes një mbushje të baterisë apo një muaj nëse gjendet në modusin “standby”.

Pajisja do të ofrohet në madhësitë 16GB, 32 GB dhe 64 GB dhe ofron këto porte lidhëse: konektor 30 pinësh për dock, një altoparlantë, mikrofoni, Bluetooth, 802.11a/b/gn

WiFi dhe 3G si veçori opsionale, si dhe një akselerometër dhe një kompas.

Gjithashtu ka një dock për tastierë, që lidhet nën orientimin portrait, pastaj ka përkrahje për dalje 1024 x 768 VGA dhe dalje 480p composite përmes kabllove të adapterit të dock-ut të ri, si dhe një shtojcë kamere që ju lejon të importoni imazhet nga kamera përmes USB-së apo drejtpërsëdrejti përmes një lexues kartelash SD.

Pajisja menaxhohet nga imunes, apo lirisht mund të themi në një proces të ngjashëm me iPhone.

Çdo gjë sinkronizohet përmes Mac-ut tuaj. Siç është pritur, pajisja mund të lëshoj aplikacionet e iPhone, qoftë në një dritare piksel-për-piksel apo në një modus të pikseluar të ekranit të plotë, por zhvilluesit gjithashtu kanë synim edhe madhësinë e re të ekranit duke shfrytëzuar SDK-në e përditësuar të iPhone OS, që u ofrua gjatë ditës së sotme.

Secili iPad është i lirë dhe arrin me një GSM “micro-SIM”, gjë që nënkupton që pajisja mund të shfrytëzohet anëmbanë botës, ku ka operatorë mobil, pra edhe në Kosovë e Shqipëri.

Çmimet fillojnë prej 499 dollarë për versionin 16GB, 599 dollarë për 32GB dhe 699 dollarë për 64 GB. Shtimi i veçorisë 3G kushton 130 dollarë për version, ndërsa modeli vetëm me Wi-Fi do të ofrohet brenda 60 ditëve të ardhshme ndërsa modelet 3G do të arrijnë pas 90 ditëve. /gazetaexpress/

9 vjeçari rrugës për certifikatën e 5-të nga Microsoft



I lindur me pasion për kompjuterë, 9 vjeçari Marko Calasan nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, nuk ka humbur kohë për tu bërë një profesionist i rangut të lartë me katër certifikime IT nga Microsoft Ai është certifikuar katër herë radhazi nga Microsoft dhe tani është duke punuar për certifikatën e tij të pestë (Bëhet e ditur se Marko preferon Bing.)

Ky është një tregim që të ngroh zemrën por që gjithashtu ju bënë të ndiheni pakëz keq për vetën tuaj. Pse? Për shkak se pavarësisht se i ka vetëm nëntë vjet, Marko është më i shkolluar për kompjuter sesa shumica prej nesh që do të jetë ndonjëherë. Ja sesi i përkrahur ai kujtimet e para rreth përdorimit të një kompjuteri: “Por kujtesa ime e parë buron nga momenti kur isha përafërsisht 3 vjeç, dhe kur isha duke bërë veprime të thjeshta siç është personalizimi i Windows, dhe pastaj instalimi i Windows, bërjen e remote desktop connections me Workstation dhe server në lokacione të largëta, e kështu me radhë.”

Për dikë që ende ka vështirësi të bëjë një veprim të tillë si vendosja e një lidhjeje remote dektop, kjo sjellë inat. Por pavarësisht të gjithave, ky djalosh i vogël nga vendi ynë fqinjë ka fituar katër certifikata MCP, MCDST, MCSA dhe MCSE dhe ai është rrugës për të fituar certifikatën e pestë për tu bërë një Trajner i Certifikuar nga Microsoft. Kur është pyetur rreth planeve për dhjetë vitet e ardhshme, Marko është shprehur se shpreson se do të shkruaj libra me instruksione për Windows 7 për përdorues të të gjitha niveleve. Ai gjithashtu u shpreh se makina e tij e preferuar për kërkim është BING. Kur u pyet nëse preferon Windows apo OSX, Calasan u shpreh i ngurrar duke thënë, “Për secilin, zgjidhja është e ndryshme, e unë përdor Windows për shkak se jam i kënaqur me sigurinë, stabilitetin, madhësinë, produktivitetin dhe me shumë avantazhe tjera që ofron sistemi operativ Microsoft Windows”. /pcworld.al/

Trajnime dhe certifikime profesionale



Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhimi

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informative
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathtësi negociimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathtësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtimi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktëve
- Aqvi Comunitare e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatike
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës

- Mbrojtja e Mjedisit
- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informative

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontrolli Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vësh të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.